



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 33 (827888)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 23 gusht 2024

Ministri Vengu: Prioriteti ynë, personel ushtarak i mirëtrajnuar, i mirëpajisur dhe i mirëpaguar



Ministri Vengu: Solidariteti european dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, shembull i shkëlqyer i misionit mes vendeve

Pas përpjekjesh intensive prej disa ditësh, misioni i shuarjes së zjarreve në Shqipëri ka përfunduar me sukses. Dy avionët ushtarakë rumunë, të tipit C-27J “Spartan” dhe C-130 “Hercules”, të cilët u angazhuan në këtë mision në kuadër të Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile, kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në luftën kundër flakëve që kishin përfshirë disa nga zonat më të rrezikuara të vendit tonë. Gjatë këtyre ditëve, avionët rumunë kanë kryer dhjetëra fluturime mbi disa nga vatrat më të nxehta të zjarrit, duke ndihmuar në izolimin dhe fikjen e flakëve në parqet kombëtare, zonat e banuara, si dhe në terrenet më të vështira dhe të paarrishme. Përpjekjet e tyre kanë qenë vendimtare për të ndaluar dëmet e mëtejshme. Gjatë gjithë misionit në Shqipëri, avioni rumun kreu gjithsej 23 hedhje, duke përdorur një total prej 141.000 litrash ujë në zonat e: liqenit të Prespës, malit të Tomorit, në fshatin Nënshetaj, në Orosh të bashkisë Mirditë, në Fushë - Bulqizë dhe në fshatin Arrën në Bashkinë e Kukësit.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, shprehu mirënjohje të thellë për stafin rumun të angazhuar në këtë operacion të ndërlikuar, duke vlerësuar profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre gjatë gjithë misionit. Ministri Vengu ka falënderuar gjithashtu Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile për mbështetjen e pakursyer dhe bashkëpunimin e ngushtë në koordinimin e këtyre përpjekjeve.

“Ky mision ishte një shembull i shkëlqyer i solidaritetit evropian dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në momente kritike. Ndihma e dhënë nga Rumania dhe Mekanizmi Evropian i Mbrojtjes Civile ka qenë e paçmueshme për menaxhimin e situatës emergjente në vendin tonë”, - tha ministri Vengu.

Një falënderim i veçantë i është drejtuar edhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila ka



luajtur një rol kyç në koordinimin dhe mbështetjen e operacionit në terren, duke bërë të mundur që përpjekjet ndërkombëtare dhe ato vendase të bashkërendohen në mënyrë efikase.

I pranishëm në këtë aktivitet, ambasadori rumun në Shqipëri, Octavian Șerban, falënderoi Bashkimin Evropian për vendimin që morën për të ndërhyrë, si dhe trupat shqiptare për punën e tyre në luftën me zjarret dhe bashkëpunimin shumë të mirë.

Avionët rumunë, që prej datës 14 gusht iu bashkuan përpjekjeve të Forcave të Armatosura dhe autoriteteve të tjera lokale për përballimin e situatës së krijuar nga zjarret.

Efektivi i kontingjentit të 15-të EOD me mision në Letoni, zhvilloi një stërvitje demonstruese, ku u improvizuan disa skenarë me natyrë EOD dhe IEDD, pjesë nga detyrat që toga EOD zgjidh në mision.

Në këtë aktivitet morën pjesë Komandanti i Grup-Batalionit Shumëkombësh dhe anëtarë të shtabit të batalionit.

Skenarët që u zhvilluan ishin:

- Improvizimi i një fushe të minuar, procedurat e çminimit manual;

- Procedurat EOD/IEDD, në një makinë bombë të improvizuar (VBIED);

- Procedurat për vënien në siguresë (RSP) të një municioni të paplasur si dhe procedurat për asgjësimin në vend (BIP) të municioneve të paplasura të paprekshme e të pa lëvizshme.

Në përfundim të aktivitetit, Komandanti i Grup-Batalionit Shumëkombësh në Letoni, shprehu vlerësime të larta për togën EOD, për performancën e shfaqur nga efektivi, disiplinën, profesionalizmin, integritetin dhe seriozitetin e treguar në të gjitha aktivitetet e Grup-Batalionit Shumëkombësh si dhe përgëzoi me Medalje dy efektive të kontingjentit të 15-të EOD.

Kontingjenti XV EOD me mision në eFP Letoni, tregon aftësitë operacionale në stërvitjen demonstruese, në përmbushje të angazhimeve të Grup-Batalionit Shumëkombësh



Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, shoqëruar nga SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, vizitoi Komandën e Forcës Tokësore në Zall - Herr.

“Forca jonë Tokësore ka qenë në pararojë të transformimeve modernizuese që prej anëtarësimit në NATO dhe mban sot peshën kryesore të kontributeve tona në sigurinë kolektive dhe në misionet jashtë vendit”, - theksoi ministri Vengu në fjalën e tij përshëndetëse para shtabit dhe efektivëve.

Kjo peshë specifike e Forcës Tokësore reflektohet dhe në angazhimin e saj në mbështetje të operacioneve të Mbrojtjes Civile dhe adresimit të fatkeqësive natyrore me 4500 efektivë pjesëmarrës në operacione të ndryshme në mbarë vendin, që prej fillimit të vitit 2024.

Ministri u ndal tek rëndësia e ofrimit të një mbështetjeje të gjithanshme për personelin tonë ushtarak: “Nuk mund të kemi programe modernizimi dhe rritje kapacitetesh të suksesshme pa vendosur në qendër të veprimtarisë sonë personelin tonë ushtarak. Kjo përbën një përparësi të qeverisë Rama, për një personel ushtarak të mirëtrajnuar, të mirëpajisur dhe të mirëpaguar”. Me rastin e prezantimit të ecursisë së proceseve të rekrutimit, ministri nënvizoi se rritja e interesit për rekrutimet afërsisht 50% më shumë se viti i kaluar dhe rekordi i aplikimeve të këtij viti për Akademinë e Forcave të Armatosura, me 1114 aplikues për 70 kuota studimi, është një sinjal pozitiv, që tregon se Forcat e Armatosura janë një pol tërheqës për gjeneratat e reja, në të gjithë gamën e profesioneve dhe karrierës prestigjioze që ofrojnë Forcat e Armatosura. “Ky sinjal duhet mbështetur, duke ofruar më shumë meritokraci, mundësi zhvillimi profesional dhe më shumë siguri ekonomike për familjet e efektivëve tanë”, - u shpreh ministri Vengu.

Në kuadër të takimit njohës me Shtabin e Forcës Tokësore, ministri Vengu i uroi gjithashtu suksese në detyrën e re zëvendëskomandantit të sapoemëruar të Forcës Tokësore, gjeneral brigade Altin Kurti.



Ministri Vengu: Nuk mund të kemi programe modernizimi dhe rritje kapacitetesh të suksesshme, pa vendosur në qendër të vëmendjes personelin ushtarak. Prioriteti ynë, një personel ushtarak i mirëtrajnuar, i mirëpajisur dhe i mirëpaguar

“FORCA JONË TOKËSORE KA QENË NË PARAROJË TË TRANSFORMIMEVE MODERNIZUESE QË PREJ ANËTARËSIMIT NË NATO DHE MBAN SOT PESHËN KRYESORE TË KONTRIBUTEVE TONA NË SIGURINË KOLEKTIVE DHE NË MISIONET JASHTË VENDIT”.



Forcat e Armatosura, pararojë e situatave kritike

KOMANDA MBËSHTETËSE

Efektivë, mjete dhe pajisje të Komandës Mbështetëse vazhdojnë të jenë të angazhuar në operacione në mbështetje të emergjencave civile për shuarjen e zjarreve në zona të ndryshme të vendit.

Forca dhe mjete të Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile (BMEC) janë vënë në dispozicion të emergjencave civile në bashkinë Finiq dhe Selenicë për shuarjen e vatrave të zjarrit. Efektivët e BMEC-së kanë qëndruar në gatishmëri dhe në monitorim të situatës në rast riaktivizimi të ndonjë vatre zjarri.

Tre autozjarrfikëse me personel nga BMEC kanë operuar për shuarjen e vatrave të zjarrit dhe kontrollin e situatës së rënduar në bashkitë Kavajë dhe Lushnjë.

Forca dhe mjete të Batalionit të Furnizimit, Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile dhe të Batalionit të Xhenios kanë kryer operacion dyditor për shuarjen e zjarrit në Malin e Thatë, bashkia Pustec.

53 efektivë të Komandës Mbështetëse kanë sfiduar terrenin e vështirë e të thepisur dhe temperaturat e larta, duke operuar në tre drejtime të ndryshme, ku përhapja e vatrave të zjarrit ka qenë e shtrirë në një sipërfaqe të gjerë dhe kanë bërë të mundur shuarjen dhe izolimin e vatrave të zjarrit, duke ruajtur të paprekur kurorën e gjelbër dhe bimësinë e lartë në këtë zonë.



FORCA TOKËSORE

Edhe këtë javë efektivat e reparteve të Forcës Tokësore janë angazhuar duke punuar pa ndërprerje në fikjen e zjarreve në fshatin Sotir, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastrë, në Bashkinë Delvinë, Qarku Vlorë, në Malin e Thatë - Bashkia Pustec, Qarku Korçë, në fshatin Ujerik - Bashkia Skrapar, Qarku Berat, në fshatin Ternovë - Bashkia Burrel, Qarku Dibër, ku janë angazhuar gjithsej 750 forca, 2 zjarrfikëse, 80 mjete transporti, si dhe 4 autoambulanca.

Edhe pse në terren dhe kushtet e vështira, duke e bërë edhe më të vështirë ndërhyrjen, është bërë e mundur fikja e rreth 25 vatrave të zjarrit si dhe sigurimi i efektivëve zjarrfikës të zonave dhe dhënia e ndihmës për eliminimin e pasojave.

Aktualisht janë 150 efektivë të Regjimentit të Operacioneve Speciale, Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut, Regjimentit të Mbështetjes me Luftim si dhe Batalionit të Këmbësorisë Lehtë, të cilët vijojnë po punojnë për të fikur vatrën e zjarrit në të gjithë territorin e vendit.

Pas shumë javësh betejë me zjarret, që përfshinë shumë territore të vendit tonë, tashmë situata paraqitet më e qetë. Aktualisht, vatra në Arrën, të bashkisë së Kukësit, ajo në Fushë - Lugje të Mirditës dhe vatra në Buçaj të Shkodrës janë të izoluar pa rrezik përhapjeje dhe po monitorohen për të shmangur çdo mundësi riaktivizimi.

Mirënjohje për të gjitha strukturat operacionale të Emergjencave Civile, që nga Forcat Zjarrfikëse, efektivët e Forcave të Armatosura, Policinë e Shtetit, Shërbimin Pyjor, Zonat e Mbrojtura dhe vullnetarët për punën e palodhur dhe angazhimin maksimal. Përkushtimi i tyre i përbashkët ka qenë vendimtar në minimizimin e dëmeve dhe mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve.



Vijojnë konkurrimet pranë AFA-së

Vijon faza e konkurrimit për t'u bërë pjesë e FARSH-së në një nga 3 programet Bachelor në AFA. Me përfundimin me sukses të kontrollit shëndetësor dhe testimit fizik, maturantët kanë vijuar konkurrimin me intervistën dhe vlerësimin psikologjik. Më datë 23 përfundon i gjithë procesi, ku me të mirët do shpallen fitues në një nga programet e AFA-së dhe do vendosin për të ardhmen e tyre.



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ,
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-n,
ZV/PRESIDENT I KËSHILLIT TË ATLANTIKUT

Në kapacitetin e Ekspertit në fushën e Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO-s, kam ndjekur me përgjegjësi shtesë dinamikën e 900 ditë/net luftime të përgjakshme në fushëbetejën për/me Ukrainën: “10-ra konferenca të Këshillit të Atlantikut, Institutit të Luftës dhe panele të ekspertëve/kolegëve elitare të sigurisë në SHBA, Bruksel, Qendrën Marshall, Gjermani, Londër, Kolegjin e NATO-s Romë; si dhe 3 Samitet e fundit, reciprokisht Madrid-2022, Vilnius-2023, Uashington 2024, etj.”!

Përfitoj nga ky rast, të sjell në vëmendjen publike se në dhjetëra vlerësime strategjike (të publikuara brenda dhe jashtë vendit), në mënyrë konstante në 2.5 vjet çmuar/optimist-izuar se: “herët ose vonë, Rusia-Putiniste do ta humbasë me turp luftën për gjunjëzimin ose pushtimin e Ukrainës martire si dhe përballjen me vlerat perëndimore dhe fuqinë e pamposhtur ushtarake të Aleancës Transatlantike (SHBA/NATO/MB/BE)”!

Dhe fatmirësisht ja ku jemi. Mbas 2 vjet gjysmë përballje stoike, më 6 gusht 2024, ushtria ukrainase ka ndërmarrë një sulm ushtarak (në 42 km front) të paparashikuar në asnjë nga skenarët edhe më optimistë (përfshi autorin), pra: “një sulm ushtarak i organizuar në befasi të plotë strategjike, duke arritur të pushtojë rajonin e Kursk-ut (afërsisht sa sipërfaqja e qytetit të Nju Jorkut ose e qarkut të Tiranës), territor brenda Rusisë që ka shërbyer si nyje me peshë kritike për mbështetjen e makinerisë kriminale të luftës në Ukrainë”.

Mbetet ende herët, për të peshuar rëndësinë e plotë të ndërhyrjes ushtarake të Ukrainës në rajonin e Kurskut, e cila gjithsesi shënon herën e parë që nga Lufta e Dytë Botërore që trupat e huaja kanë pushtuar territor rus. Por, konsideruar edhe reagimin fillestar të Putinit dhe zyrtarë të tjerë të lartë, të cilët po vijnë të sforcohen për të minimizuar peshën e ofensivës së suksesshme të FA-ve të Ukrainës në Kursk, duke e cilësuar atë si: “një sulm terrorist dhe një provokim të armatosur ndaj sovranitetit të Rusisë”, pothuaj të gjithë strategët e pranojnë se pesha gjeostrategjike, tejkalon shumë përtej rëndësisë ushtarake.

Prandaj më duhet po ashtu ta nënvizoj fort, atë çka është konfirmuar edhe nga Kievi Zyrtar, se: “Ukraina nuk ka patur kurrë dhe nuk ka kurrësi qëllim në vetvete pushtimin e Kurskut dhe as një meter² të territorit të Rusisë, por mbetet në të drejtën e doktrinës së mbrojtjes sovraane që të shkatërrojë (me çdo mjet) si dhe të marrë nën kontroll një nga nyjet nevralgjike të infrastrukturës për mbështetjen ushtarake dhe logjistike të armikut (Rusisë – Putiniste) kundër sovranitetit territorial të Ukrainës”.

Gjithsesi, në vijim, po paraqes një përmbledhje strategjike: “pse Pushtimi i Kurskut, përbën një ndër tre turpërime, ose 3 poshtërime e mëdha që Rusia-Putiniste ka pësuar nga 24 Shkurti 2022 – Gusht 2024”:

Poshtërimi i parë (shkurt-shtator 2022)

Dështimi i sulmit të forcave ruse, ose makinerisë Putiniste u shënuar që në nisjen e luftës për pushtimin e Ukrainës. Tërheqja e turpshme e forcave ruse nga rrethinat e kryeqytetit Kiev, në mars 2022, ose në më pak se një muaj pas fillimit të ofensivës neonaziste, u pasua me humbje të tjera ushtarake për Kremlinin, duke përfshirë fundosjen e “nëndetësës Moskva”, ose krenaria e flamurit të Flotës Ruse në Detit të Zi, më 14 prill 2022! Nuk mund të kishte turpërim më të madh për Rusinë sesa humbja e nëndetësës me peshë gjeostrategjike në luftën ndaj një vendi me marinë, ose forca detare të limituara/modeste!

Po në shtator dhe tetor 2022, Ukraina nisi kundërofensivën për të rimarrë iniciativën strategjike të luftës, duke çliruar pjesë të territorit të pushtuar nga Rusia, si rajonet Kharkiv dhe Kherson, të vetëshpallura nga Putini me “referendume nën bajoneta si pjesë jetike e sovranitetit të mëmës Rusi”.

Për më tepër, rezultati i poshtërimit të parë të madh ishte, edhe izolimi dhe diskreditimi i Putinit në arenën ndërkombëtare. Kështu kur Rusia nisi luftën për pushtimin e Ukrainës, më 24 shkurt 2022, vetëm Kim-Jongu dhe 4 shtete terroriste e mbështetën, ndërsa shumica e analistëve besonin se lufta do të përfundonte brenda pak javësh ose maksimumi më 9 maj “fitorja e madhe do celebruhej me lule, kënge dhe valle në Kiev”. Por nga fundi i vitit 2022 (edhe sot), makineria e luftës ruse “po zvarritej/t e përgjakur dhe rraskapitur”, duke pushtuar më pak se 19 % të territorit Ukrainas”. E thënë ndryshe, Rusia nuk dukej/t më e pathyeshme, ndërsa Putini dukej/t edhe me i vockël/shkurtër se sa është në realitet.

Përtej izolimit stalinist, propagandës neo-bolshevike dhe mendjeve të ndryshkura, jo vetëm në Moskë dhe Beograd, performanca e fuqisë ushtarake ruse që në fundin e vitit 2022 e dobësoi ndjeshëm Putinin.

Ndërsa shumë të zhgënjyer mbetën edhe kleptokratët e Ukrainës, të cilët ëndërronin të ktheheshin në status quo-në e paraluftës. Me fjalë të tjera, Ukraina e ndali me sukses pushtimin e vendit, ndërsa

“Pushtimi i Kurskut, ndër 3 poshtërime të mëdha të Putinit në Ukrainë!



Kremlini vazhdoi të izolonte dhe varfëronte vendin, çka shtroi transhenë për poshtërimin e madh të radhës edhe të mbi-Pushtetit të Putinit.

Poshtërimi i dytë (qershor-gusht 2023)

Poshtërimi i dytë i madh i Rusisë - Putiniste nuk erdhi vetëm nga rezistenca stoike e Ukrainës dhe mbështetja e pakushtëzuar e Perëndimit, por edhe nga brenda makinerisë kriminale të Kremlinit. Rebelimi në qershor 2023 i Prigozhit dhe ushtrisë së mercenarëve rreth tij (Grupi Wagner), ekspozoi çarje të thella në elitën politike dhe kohezionit të kombit rus rreth luftës; demonstroi kalbëzimin e moralit të ushtrisë si dhe brenda zinxhirit të komandimit të Forcave të Armatosura Ruse.

Fakti që Prigozhin, një mik i ngushtë i Putinit që nga 1990, do të niste një rebelim kundër Kremlinit, ilustroi rreziqet e “politikës së sipërmarrjes”, pra i kalimit të përgjegjësisë të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, aktorëve të sektorit privat, ose oligarkisë Putiniste. Këto struktura paramilitare (jo-zyrtare), do të kishin mirë funksionuar vetëm nëse lideri rus do të vazhdonte të ishte i fortë. Ndërsa ky rast tregoi se Putini ishte i dobët, prandaj situata doli jashtë kontrollit deri sa degradoi te rebelimi i Prigozhinit (Grupit Wagner).

Dhe fakti që Prigozhin mund të merrte kontrollin e qytetit të Rostov-on-Don, për t’u mirëpritur si hero si dhe të marshonte me mercenarët e tij në veri, deri në periferi të Voronezh, afërsisht 300 milje nga Moskë, e shpoi edhe më shumë anijen e (pa) plotfuqishmërisë së Putinit.

Prigozhin, natyrisht e pagoi çmimin e rebelimit, duke mbetur i vdekur në një “aksident ajror” së bashku me shtabin e ngushtë (9 vetë), përfshi bashkëthemeluesin e Wagner, Dmitry Utkin, më 23 gusht 2023. Por sipas burimeve perëndimore të inteligjencës, përplasja nuk ishte aksident, por një atentat i mirë-organizuar nga ndihmësi i vjetër i Putinit, Nikolai Patrushev. Sidoqoftë kjo histori i turpëron të dy palët.

Kështu, poshtërimi i dytë i madh i Putinit nuk thelloi vetëm ndarjet në elitën politike dhe qeverisëse të Rusisë të ekspozuara nga mos-pushtimi i Ukrainës, por edhe dobësinë themelore të forcave të armatosura në përmbushjen e misionit kushtetues: “mbrojtjen e atdheut”! Kjo, nga ana tjetër, krijoi terrenin edhe për poshtërimin e radhës, sigurisht më të madhin por jo të fundit të Rusisë - Putiniste.

Poshtërimi i tretë i madh (6 gusht 2024)

Operacioni i pushtimit të rajonit të Kurskut nga FA-të e Ukrainës, ishte i planifikuar dhe u ekzekutua në fshehtësi të rreptë strategjike, duke sjellë edhe një tronditje të madhe për fatet e luftës. Në vend të zhurmës së vazhdueshme të medias (dezinformuese) për disa fitore operacionale të ushtrisë Ruse në Donbas, “New York Times” me sarkazëm pushtimin e Kurskut, e cilësoi si: “mashttrim dhe bixhoz i trupave ukrainase”.

Nga dorëzimet masive të trupave ruse dhe evakuimi kaotik i civilëve, deri të përparimet e forcave ukrainase më thellë (rreth 25 km) në territorin rus, operacioni Kursk-ut ekspozoi dobësinë jo vetëm të FA-ve dhe të shtetit Rus, por edhe si paralajmërim për fundin e perandorisë së Rusisë – Putiniste.

Gjatë sundimit të tij (Putinit) prej rreth çerek shekulli, kontrata

e regjimit të Putinit me solidaritetin e shoqërisë dhe kohezionin e kombit rus ka qenë e bazuar në rivendosjen e madhështisë dhe ambicieve perandorake të humbura mbas viteve 1990. Por bashkë me “pushtimin e Kurskut” duket se qeveria/regjimi i Putinit ka (keq) dështuar në përmbushjen e përgjegjësisë themelore të çdo shteti normal: “mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe qytetarëve të tij nga pushtimi i huaj”. Ndërsa fakti që Putini ka ngarkuar një nga ish-truprojat e tij, Aleksei Dumin (të cilin mediat ruse e quajnë “ministri i mbrojtjes në hije” i Rusisë), për t’i dhënë fund ofensivës së Ukrainës, demonstroi panikun si dhe fatin e ministrit të mbrojtjes të emëruar së fundmi (Belousov), i cili duket se e (keq) zhgënjëu Kremlinin: “pasi nuk u tregua në lartësinë e detyrës”!

Gjithsesi, rrethanat, përmasat dhe pasojat ushtarake të sulmit/pushtimit të guximshëm të Kurskut nga Ukraina janë ende të paplota. Mund edhe të rezultojë, siç e komentoi ish-ndihmës sekretari amerikan i shtetit, Daniel Fried: “një George Washington që kapërcen lumin Delaware (1776)”.

Ndërsa në një postim të zgjuar Gjeneral (R) Australian Mick Ryan vuri në dukje se “mbas këtij inkursioni të suksesshëm, Ukraina ka 2 opsione: (a) të përpiqet të mbajë territorin që ka kapur brenda Rusisë (Kurskun), ose (b) të tërhiqet në Ukrainë pasi e ka arritur qëllimit politik për ta poshtëruar epërsinë strategjike të Kremlinit në luftë”. Nga ana tjetër edhe Putini, po përballet me një zgjedhje shumë të vështirë nëse do t’i duhet të tërheqë (siç në fakt po ndodh) trupat tokësore nga fronti në Ukrainë lindore për të rimarrë territorin rus në rajonin e Kurskut!?

Pavarësisht skenarëve ushtarakë, dëmi politik është shkaktuar dhe i ka rrënjët jo vetëm te pa-fuqia ushtarake, por pikësepari në politikën neo-staliniste të Kremlinit. Thënë këto, shteti rus “nën pushtimin e Putinit (KGB-së)” ngjason në thelb me tiparet e një organizate të kimit të organizuar, pasi si strategjia, përqasja, armatimet dhe kërcënimet ushtarake, janë po njësoj me ato të një familjeje mafioze. Ndërsa siç njihet momenti më destabilizues si dhe i sjelljes si “bishë e plagosur”, për një bandë kriminale është kur bosi i mafies duket i dobët...!

E parë sa më sipër, e përsërisim se fushëbeteja e Kursk-ut, nga ajo e lavdisë së ushtrisë së kuqe, 81 vite më parë (12 korrik 1943), këtë radhë (6 gusht 2024) do të shënojë jo vetëm fillimin e rrokullmës drejt humbjes turpëruese të luftës që e pret Putinin në Ukrainë (një komb martirësh dhe vend sovran), por edhe të gjunjëzimit dhe poshtërimit në përballjen me fuqinë ushtarake si dhe me vlerat demokratike, kredibilitetin dhe interesat gjeopolitike të Aleancës Transatlantike (SHBA/NATO/BE)!

Në shtesë, do ishte e padrejtë të mos përsëhendesnim përpjekjet relevante të Shqipërisë, si rrjedhojë e përfaqësimit krah SHBA-ve në Këshillin e Sigurimit/OKB; rolin aktiv dhe mbështetjen e pakushtëzuar të vendimmarrjeve të NATO-s, si dhe kontributet më shumë se modeste që RSH i ka dhënë gjatë 30 muajve Ukrainës në këtë përballje “për jetë a vdekje” me të keqen e përbashkët.

Zoti e bekoftë fitoren në Ukrainë, fuqinë ushtarake të NATO-s, vlerat demokratike si dhe ardhmërinë Euroatlantike të Kombit Shqiptar si SHBA dhe gjithë Europa.

Kërkesë për ndihmë nga Ukraina: përgjigje emergjente

Shërbimi Shtetëror i Emergjencave të Ukrainës ka lëshuar një kërkesë për ndihmë ndërkombëtare nëpërmjet mekanizmit të reagimit ndaj emergjencave të NATO-s, Qendra e Koordinimit Euro-Atlantik për Reagimin ndaj Fatkeqësive. Kërkesa është për pajisje të rënda për të mbështetur reaguesit civilë të urgjencës që merren me pasojat e sulmeve të përditshme të Rusisë ndaj infrastrukturës civile në Ukrainë.

Qendra e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive Euro-Atlantike (EADRCC)

Qendra Euro-Atlantike e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive (EADRCC) është mekanizmi kryesor i NATO-s për reagimin ndaj emergjencave civile. Ai është i disponueshëm për të gjithë aleatët dhe vendet partnere dhe mund t'i mbështesë ata me përgjigje dhe gatishmëri për fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu dhe emergjenca të tjera.

- EADRCC luan një rol lehtësues në koordinimin e ofertave të mbështetjes dhe kërkesave për ndihmë ndërmjet vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s. Në rastin e një fatkeqësie që kërkon ndihmë ndërkombëtare, i takon aleatëve dhe partnerëve të NATO-s të vendosin nëse do të ofrojnë ndihmë bazuar në informacionin e marrë nga EADRCC.

- Nëpërmjet punës së tij për ngritjen e kapaciteteve dhe ushtrimeve të mbrojtjes civile, EADRCC ndihmon aleatët dhe partnerët të përmirësojnë aftësinë e tyre për të punuar së bashku në përgjigjen ndaj fatkeqësive, duke forcuar aftësitë e tyre për të përballuar një gamë të gjerë emergjencash. Kjo është thelbësore për qëndrueshmërinë kombëtare dhe kolektive përballë sfidave gjithnjë në rritje si ato të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, terrorizmi dhe konflikti.

- Përveç fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të shkaktuara nga njeriu, Qendra është gjithashtu në dispozicion për të koordinuar ndihmën ndërkombëtare gjatë situatave të krizave dhe të nenit 5 të mbrojtjes kolektive.

- Detyrat e EADRCC kryhen në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (UN OCHA), e cila ruan rolin parësor në koordinimin e operacioneve ndërkombëtare të ndihmës ndaj fatkeqësive.

Mbështetje për autoritetet kombëtare në emergjencat civile

EADRCC mund të mbështesë aleatët dhe partnerët në një gamë të gjerë emergjencash, nga fatkeqësitë natyrore, aktet e terrorizmit dhe krizat e tjera, e deri te situatat e mbrojtjes kolektive. Ka qenë një pjesë integrale e përgjigjes së NATO-s ndaj pandemisë COVID-19; Mbështetja e NATO-s për popullsinë civile të Ukrainës gjatë gjithë luftës së agresionit të Rusisë; Mbështetja e Aleancës për Turqinë pas tërmeteve të vitit 2023; evakuimi i afganëve të NATO-s dhe familjeve të tyre nga Afganistani në vitin 2021, dhe shumë fatkeqësi të tjera natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu.

Në rast urgjence, NATO-ja ose vendi partner i prekur mund të kërkojë mbështetje nëpërmjet EADRCC. Qendra shpërndan kërkesat për ndihmë, koordinon ofertat dhe mundëson dhënien e shpejtë të ndihmës, duke punuar në kontakt të ngushtë me autoritetet e mbrojtjes civile të aleatëve dhe partnerëve. EADRCC gjithashtu mund të ndihmojë në gjenerimin e ndihmës ushtarake në përgjigjen ndaj fatkeqësive, aty ku është e nevojshme, dhe u siguron aleatëve dhe partnerëve ndërgjegjësimin e situatës për emergjencën në fjalë, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të mirëinformuara.

Në një krizë, EADRCC koordinohet ngushtë me Autoritetet Ushtarake të NATO-s, Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (OKB OCHA) dhe organizata të tjera ndërkombëtare të përfshira në reagimin emergjent.

Midis 2020 dhe 2023, EADRCC luajti një rol kyç në mbështetjen e NATO-s për aleatët dhe partnerët në trajtimin e pandemisë COVID-19. EADRCC ndihmoi në lehtësimin e transferimit të furnizimeve mjekësore si maska, doreza, dezinfektues dhe ventilatorë në vendet që kërkuan ndihmë.

Në 2022-2023, EADRCC ishte instrumentale në mbështetjen e NATO-s për civilët ukrainas të prekur nga lufta e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. Nëpërmjet Qendrës, aleatët dhe partnerët ndihmuan refugjatët ukrainas, trajnuan paramedikët ukrainas në Ukrainë dhe ofruan ambulanca dhe furnizime thelbësore për



Zhytësit e kërkim-shpëtimit sinjalizojnë se kanë gjetur një viktimë të simuluar gjatë stërvitjes EADRCC Maqedonia e Veriut 21

objektet e ndihmës së parë në Ukrainë.

Në vitin 2023, EADRCC koordinoi mbështetjen e Aleancës për Turqinë pas tërmeteve shkatërruese që ishin fatkeqësia më e madhe natyrore në historinë e NATO-s. Ndihma u mobilizua përmes mjeteve civile dhe ushtarake, dhe përfshinte strehim dhe mbështetje të tjera të hershme për të mbijetuarit.

Përmirësimi i elasticitetit përmes stërvitjeve

EADRCC kryen aktivitete të rregullta për ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnime në vendet aleate dhe partnere. Këto aktivitete ndihmojnë në rritjen e qëndrueshmërisë kombëtare përmes përmirësimit të gatishmërisë ndaj fatkeqësive dhe rrisin aftësinë e një vendi për të menaxhuar incidentet dhe krizat - nga reagimi ndaj fatkeqësive deri te sfidat më të gjera të sigurisë.

Qendra ka organizuar 19 ushtrime kryesore të mbrojtjes civile, të cilat zhvillohen afërsisht çdo tre vjet; më i fundit u zhvillua në vitin 2021 në Maqedoninë e Veriut.

Ekipi shumëkombësh i ekspertëve

Qendra ndodhet në selinë e NATO-s në Bruksel, Belgjikë. Ai përbëhet nga një ekip i vogël, por mund të rritet ndjeshëm në një krizë. EADRCC gjithashtu mbështetet në ekspertizën e ekspertëve civilë kombëtarë, të cilët mund të thirren për të ofruar këshilla në fusha të veçanta në rast të një fatkeqësie të madhe.

Historik i shkurtër

EADRCC u krijua në 1998 nga Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC) për të mbështetur aleatët dhe partnerët e NATO-s me planifikimin dhe reagimin e emergjencës civile. Ndërtimi i bashkëpunimit të NATO-s me partnerët në fushën e reagimit

emergjent ishte fillimisht një propozim rus dhe një shembull i bashkëpunimit të frytshëm që NATO-ja dhe Rusia kishin dikur në interes të sigurisë ndërkombëtare.

Vetëm pak ditë pas krijimit të saj, EADRCC u thirr për të koordinuar ndihmën humanitare nga vendet e EAPC për refugjatët kosovarë në Shqipëri gjatë luftës në Kosovë në fund të viteve 1990.

Gjatë gjithë viteve, mandati i EADRCC është zgjatur periodikisht për të përfshirë reagimin e mundshëm ndaj sulmeve terroriste; incidentet kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN); dhe urgjenca të tjera. Ajo ka qenë gjithashtu e ngarkuar t'u sigurojë aleatëve, partnerëve dhe Autoriteteve Ushtarake të NATO-s ndërgjegjësimin e situatës rreth evolucionit të krizave dhe fatkeqësive, për t'i ndihmuar ata të marrin vendime të mirë informuara. Në vitin 2009, vendeve të Dialogut Mesdhetar (MD) dhe atyre të Iniciativës së Bashkëpunimit të Stambollit (ICI) iu dha akses i drejtpërdrejtë në EADRCC, të ndjekur nga partnerë të tjerë anëmbanë globit në dhjetor 2011.

Qendra ka qenë pjesë e përgjigjes së NATO-s ndaj një game të gjerë incidentesh, duke përfshirë epideminë e Ebolës dhe pandeminë COVID-19, flukset e refugjatëve në vendet aleate dhe partnere, luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës dhe fatkeqësitë e mëdha natyrore, duke përfshirë uraganet, zjarret në pyje, përmytjet dhe tërmetet.

Sot, EADRCC është një mjet që mbështet të tre detyrat kryesore të NATO-s: parandalimin dhe mbrojtjen, parandalimin dhe menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Gushti i nxehtë i vitit 1944, mund të quhet edhe muaji i krijimit të brigadave sulmuese: BrXIVS, BrXVIS, BrXVIIIIS dhe BrXIXS. Ndërkohë më 15 gusht 1943 ishte krijuar famëmadhja BrIS.

Brigada e ruajtjes së bregdetit

Brigada XIV Sulmuese (BrXIVS) u formua më 17 gusht 1944, në Sheper të Zagorisë. Në përbërje të saj u përfshinë GriP i Kurveleshit, GriIP i Mallakastrës dhe GriVP “Çamëria” që bënë pjesë në ZIOp. Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër. Efektiv i reparteve të brigadës përbëhej nga 559 luftëtarë që përbënin tre batalione të saj e që partizanët kishin një përvojë luftarake prej më shumë se një viti, përmes aksioneve dhe luftimeve kundër pushtuesve dhe tradhtarëve. Në momentin e krijimit, brigada kishte: 196 partizanë analfabet, 92 komunistë, 400 të rinj dhe 142 të rinj që ishin të organizuar në Rininë Komuniste, mbi 50 gra dhe vajza, 3 partizanë italianë.

Në komandë të brigadës ishin: komandant Gjon Banushi, komisar Karaman Ylli, zëvendëskomandant Halil Kaçanolli, zëvendës komisar Gafur Çuçi. Brigada mbulonte një sektor të gjerë veprimi që përfshinte Libohovë-Pogon, Lunxhëri-Cepo-Rrozom. BrXIVS dha në vazhdimësi goditje në qarkun e Gjirokastrës, duke e detyruan armikun të mbyllej në vendet e fortifikuara në qytet. Armiku kurrë nuk u la i qetë, kjo dhe në bashkëpunim me forca të tjera partizane të zonës. Betejë e brigadës ishte sulmi mbi kalanë e Borshit dhe të forcave armike në bregdetin e Sarandës, më 18 shtator 1944. Luftimet e ashpra bënë të mundur që forcat partizane të vinin nën kontroll kalanë e Borshit dhe pjesën më të madhe të bregdetit të Sarandës. Më 19 shtator 1944, brigada sulmoi armikun në Jergucat e Gjirokastrë. Gjirokastra që njeh disa luftime të zhvilluara në qarkun e saj, por edhe më gjerë, luftimet e 2 tetorit 1943, kundër forcave naziste të zhvilluara në urën e Kardhiqit e Manastirin e Cepos, por dhe në Gjorm të Vlorës, të zhvilluar nga batalionet “Asim Zenel” dhe “Halim Xhelo”, të cilët formuan Grupin I Partizan të Zonës I Operative. Më 22 shtator 1944, b1p i brigadës, në bashkëveprim dhe me forcat e BrXIIS rrethoi gjermanët në Qafën e Kakomes, ku pati të vranë, të plagosur dhe të zënë rob, si dhe material luftarak. Më 9 tetor BrXIVS së bashku me BrXIIS mori pjesë në luftën kundër pushtuesve gjermanë që ishin përqendruar në Sarandë. Në këtë luftë të ashpër që zgjati tri ditë, armiku përsëri pësoi humbje të rënda në njerëz dhe teknikë luftarake.

Lufta e fundit e BrXIVS ishte sulmi për çlirimin e qytetit të Delvinës, ku ndodheshin 800 gjermanë të përqendruar në fortifikata.



Në bashkëveprim edhe me partizanët e BrXIXS, i detyroi armiqet të tërhiqeshin në panik nga qyteti, duke lënë në fushën e luftës mjaft të vranë e të plagosur, si dhe shumë material luftarak. Për çlirimin e Sarandës e Delvinës është luftuar deri trup me trup, duke patur të vranë e të plagosur nga të dyja palët. Në këto luftime u plagos edhe komisar i brigadës Kareman Ylli, luftëtar trim që ishte kudo në ballë të luftës dhe orator i fjalës për beteja të fuqishme kundër armiqve të Shqipërisë. Në tetor 1944 BrXIVS u inkadrua në Divizionin III Sulmues. BrXIVS ruajti jo vetëm kufirin jugor, por mbrojti dhe kufirin bregdetar të Shqipërisë në detin Jon, duke vepruar sipas udhëzimeve të Shtabit të Përgjithshëm në marrëdhënie me aleatët, të cilët vepronin në ujërat territoriale në brigjet e Shqipërisë. Me çlirimin e Shqipërisë, BrXIVS u vendos në ruajtje të Vlorës dhe Sazanit.

Brigada i dha Atdheut mjaft dëshmorë midis të cilëve janë: Anife Metaj nga Tërbaçi i Vlorës, Ali Gorici nga Picari i Kurveleshit, Sefer Koshi nga Konja e Kurveleshit, Filo Faslliu nga Kallarati, Idriz Miçi nga Borshi, Grigor Diamanti nga Narta, Zeqir Demo nga Kanina, Isa Xhuli nga qyteti i Gjirokastrës, Demo Zeqiri nga Mallakastra, Gjysho Jaçe nga Drizari i Mallakastrës, Zeqir Hoxha nga Peshkëpia e Vlorës dhe Antonio Giuseppe Italian.

Brigadat sulmuese të krijuara në gusht 1944



Brigada që çliroi fshatra e krahina të Myzeqesë dhe qytetet Fier e Lushnje

Brigada XVI Sulmuese (BrXVIS) në zbatim të planeve të Komandës së Përgjithshme për formimin e njërive të UNÇSH-së dhe çlirimin e plotë të vendit, Komandanti i Përgjithshëm i UNÇSH-së, Enver Hoxha, urdhëroi krijimin e BrXVIS me zonë veprimi në krahinën e Myzeqesë, kryesisht në trekëndëshin Lushnje-Fier-Berat. Urdhri përcaktonte partizanët e brigadës prej 520 vetash, duke arritur në 1300 luftëtarë. Në efektiv do të ishin GriIP i Skraparit, GriIP i Mallakastrës, GriP i Kurveleshit dhe Gr i Myzeqesë. Mbi 85% të efektivit ishin të rinj e të reja në moshë 15-30 vjeç, dhe rreth 60 ishin gra e vajza. Data e formimit të BrXVIS është 20 gusht 1944 dhe vendi Therapel i Skraparit.

Komanda e brigadës përbëhej nga Rrahman Ruçi, komandant, Avdyl Këllëzi, komisar, Gjon Gjoni, zëvendëskomandant dhe Myzafer Trebeshina, zëvendës komisar. Në zbatim të urdhrit të Komandës së Përgjithshme, shtabi i brigadës u përcaktoi detyrat dhe vendndodhjet tre batalioneve të saj. Brigada zonë veprimi kishte Pashik, Aranitas, Lokfend dhe kryesisht Myzeqe në një sektor shumë delikat e të rëndësishëm. Detyra kryesore nga Shtabi i Përgjithshëm, ishte që brigada të godiste autokolonat armike gjatë rrugëve: Vlorë-Fier; Fier-Lushnje, Berat-Ura e Kuçit-Lushnje, në Qafën e Koshovicës e të hidhte në erë urat, depot e kazermat që përdoreshin prej armikut; të godiste e shpartallonte forcat e nazistëve e bashkëpunëtorëve të tyre. Brigada luftoi 48 ditë dhe gjatë këtyre ditëve zhvilloi mbi 45 aksione, pothuajse çdo ditë një aksion, të cilët i shkaktuan armikut dëme të mëdha. Karakteristika e brigadës ka qenë se gjithnjë ndoqi taktikën e sulmit dhe në të gjithë rastet iniciativa ka qenë në duart e partizanëve, armiku nuk qe asnjëherë, në gjendje që ta godiste brigadën në befasi. Dita e fillimit të aksioneve luftarake ishte 2 shtatori

1944, ku b3p, pasi kaloi lumin e Osunit, vendoset në kodrat e Mbrostarit dhe së bashku me b2p sulmojnë forcat gjermane në Ardenicë, që pas një sulmi të shkurtër i shpartallon dhe i djeg 5 depo me municione. Batalionet kryen aksion kundër depove gjermane në kodrat e Petovës, në rajonin Poshnje-Uji i Ftohtë, si dhe spastrimin e zonës së Myzeqesë nga forcat e Ballit Kombëtar, detyrë e kryer në 10-ditëshin e parë të shtatorit, duke likuiduar 15 baza të reaksionit. Me veprimet luftarake brigada çliroi fshatra e krahina të tëra të zonës së Myzeqesë. Detyra për çlirimin e Fierit iu ngarkua b3p dhe GriIP të Mallakastrës në një grup operativ të përbashkët. Me sulme e kundërsulme forcat partizane çlijuan Fierin, më datën 15 tetor 1944. Sulmi për çlirimin e Lushnjës filloi në mbrëmjen e 17 tetorit në koordinim me b2p të BrVIIIIS, Partizanet triumfuan më 18 tetor 1944. Mbas kësaj date brigada spastroi zonën nga mbeturinat balliste dhe filloi të merrte pjesë në rindërtimin e shtëpive dhe të ekonomisë.

Nga radhët e BrXVIS ranë mbi 53 dëshmorë, midis tyre Heroina e Popullit Liri Gero që nazistët e dogjën trupin e pajetë të saj, Sadush Myftari, Mustafa Radovicka, Nako Bozo, Rrapo Luçi, Feride Hakimi, Izet Rrapo, Islam Klosi, Shaban Turku, Vedut Dokollari, Kozma Voja etj.

Patriotizmi i lartë, pjesë e pandarë e shpirtit partizan

Brigada XVIII Sulmuese (BrXVIIIIS) u krijua më 18 gusht 1944, në Sllatinë të Peshkopisë nga batalionet e “Dibrës”, “Martaneshit” e “Çermenikës” dhe vullnetarë të rinj nga krahinat e Dibrës etj. Brigada u organizua në 4 batalione, me një efektiv fillimisht 650 luftëtarë, në ditën e çlirimit në 1623 dhe në 2140 në mars të vitit 1954.

Në komandë ishin komandant Esat Ndreu dhe komisar Miço Kallamata. Më pas në shtabin e saj u bënë ndryshime: Komandant Zoi Themeli; zëvendëskomandant Petrit Dume e Xhemal Petrela; komisar Ilmi Çausholli dhe zëvendës komisar Teme Sejko e Milo Qirko.

Brigada kreu rreth 17 luftime e operacione kundër pushtuesve gjermanë e bashkëpunëtorëve të tyre ballisto-zogistë e bajraktarëve. Luftimet e para i zhvilloi së bashku me BrVS në Malin e Korabit, kundër forcave gjermane dhe mercenarëve që bashkëpunonin me



ta. Luftime të ashpra zhvilloi edhe në Lumë, në Kukës e në afërsi të Prizrenit. Nga lufta që zhvilluan partizanët e kësaj brigade dështoi operacioni armik “Feksenjagd”, që synonte pushtimin e Peshkopisë. Dy batalione të BrXVIIIIS, së bashku me BrVS, më 2 shtator 1944, çliuan qytetin e Dibrës. Luftime të ashpra u zhvilluan në Kalanë e Dodës dhe në krahinën e Lumës, ku ishin përqendruar forca të shumta të armikut. Më 21 shtator 1944, ajo shkatërroi krejtësisht forcat gjermano-balliste. 27 shtator, brigada 1944 bëhet pjesë e Divizionit IV Sulmues të Korparmatës I. BrXVIIIIS, mori pjesë dhe në luftimet përtej kufirit shtetëror në Dibrën e Madhe. Ishte një nga njësitë partizane që mori pjesë aktive në çlirimin e qytetit të Kërçovës, ku ra partizania trime Hibe Palikuqi, Heroinë e Popullit. Një seri luftimesh kundër nazistëve gjermanë zhvilloi edhe në tërheqjen nga Kosova për në Shkodër gjatë rrugës Prizren-Kukës-Pukë dhe, bashkë me BrVS, mori pjesë në çlirimin e qytetit të Prizrenit, më 17 nëntor 1944, si dhe sulmoi dhe shpartalloi kolonën e ushtrisë armike që po vinte nga Prizreni në Kukës. Dhe më 18 nëntor 1944, në bashkëpunim edhe me forca të tjera partizane çliroi Kukësin. Brigada kreu detyra si mbrojtjen e kufirit në zonën e Kukësit e, më pas, bëhet pjesë e Korpusit të Parë me qendër në Tiranë. Nga radhët e kësaj brigade ranë heroikisht, mbi 30 dëshmorë, midis tyre Heroina e Popullit Hibe Palikuqi dhe Jashar Kola, Hamdi Lleshi e Ahmet Cami, etj.

Historia e BrXIVS; BrXVIS; BrXVIIIIS janë pjesë e historisë së madhe të LANÇ-it

Ato shkruan historinë e tyre për çlirimin e vendit me gjak e sakrifica dhe do të kujtohen brez pas brezi nga populli shqiptar dhe FA-të. Një nga tiparet dalluese të brigadave sulmuese ka qenë patriotizmi, vullnetarizmi dhe masivizimi, që u bënë pjesë e pandarë e virtyteve dhe karakterit të popullit liridashës shqiptar, që ndër shekuj ka luftuar për mbrojtjen e trojeve të veta nga copëtimi. Kudo, në çdo aksion e luftim, luftëtarët e saj manifestuan frymën e lartë të patriotizmit partizan, dashurinë e madhe ndaj atdheut dhe popullit dhe urrejtjen ndaj pushtuesve. Jo më kot populli u ka ngritur këngë djemve luftëtarë patriotë të brigadave sulmuese, trimave të malit që për Atdheun nuk të falnin. I kujtojmë sot këto njësi luftarake, familjeve të dëshmorëve, bijve e bijave, nipërve e mbesave të partizanëve, luftëtarëve për liri e pavarësi, ua kujtojmë veteranëve të LANÇ-it dhe pasardhësve të tyre që mbajnë ndezur idealet e shenjtë të asaj lufte, që pinjollët e nazifashistëve i quajnë kriminelë, sepse luftuan e fituan mbi nazifashizmin. Përmes sakrificave të panumërta partizanët sollën çlirimin e vendit, prandaj duhet ta ngrenë më lart frymën e atdhetarisë e patriotizmit, për ta mbajtur ndezur në çdo vatër këtë zjarr dhe të mos lejojnë më të hidhet baltë mbi veprën e shenjtë të popullit shqiptar.

Ti, je një ‘Teutë’!

Mbretëresha Teutë (e njohur pos tjerash edhe si pirate) do mbahet mend përgjithmonë në kronikat e shumta historike si njëra prej mbretëreshave më të bukura, më të shkathëta, energjike, luftarake, të zgjuara, më inteligjente në historinë e përgjithshme të globit dhe civilizimit tonë njerëzor. Në kohën e sundimit (mbretërimit) të Teutës: Mbretëria Ilire e Ardianëve (Ardiejeve) kishte monopol ose dominim të plotë në detet e Jonit, Egjeut dhe Adriatikut. Për të mos thënë në tërë Rajonin (Regjionin) e njohur të Mesdheut ose Mediteranit, saqë, mbreti (perandori) romak, Polybie, asokohe, pas replikave ose polemikave të rrepta me mbretëreshën Teutë, kishte ngritur padi ndërkombëtare kundër Teutës dhe piratëve ose kusarëve të saj detarë, të cilën Teuta e Ilirisë e kishte hedhur poshtë, duke e refuzuar me forcë diktatin ose padinë e mësipërme të perandorit romak (Polybie) me fjalët: “Askush në këtë botë nuk guxon dhe s’ka të drejtë me e penguar lundrimin e anijeve detare, tregtare ose ushtarake të Ilirisë në detet e lira të Egjeut, Jonit dhe Adriatikut!”, fund i citatit. Ndërkohë që Teuta kishte dhënë urdhër për marshimin e trupave ose luftanijeve ilire në gjirin e Korfuzit, Sazanit dhe Korintit, për të penguar depërtimin e luftanijeve romake në rajon. Ishte ajo një “paralojë ushtarake ose luftarake” e forcave ilire para luftërave ose betejave të ardhshme kundër Hanibalit dhe ushtrisë romake, kundër galëve (në Galinë e Epërme ose Cisëalpine), kundër kartagjenasve etj. Së këndejmi, Teuta thuhet se erdhi në krye të fronit mbretëror të Ilirisë pas vdekjes së papritur të bashkëshortit të saj, Agronit, i cili thuhet se vdiq nga një helmim i rëndë në pije alkoolike tek po kremtonte një fitore ushtarake me komandantët ose bashkëluftëtarët e tij diku në Epir ose Paksos (Paxos) të Greqisë së sotme. Agroni e kishte trashëguar fronin mbretëror nga Aleksandri, i cili kishte qenë i biri (djali) i Pirros të Madh, duke e shtrirë dhe zgjeruar kështu mbretërinë ardiane të Ilirisë në kohë dhe hapësirë. E sidomos në kohën e luftërave të njohura iliro-romake që kishin filluar nga viti 229 dhe kishin zgjatur deri në vitin 168-para epokës së re. Pas vdekjes së Agronit: Teuta si bashkëshorte e dytë e tij, dhe mbretëreshë e re e Ilirisë: Për komandant suprem të marinës dhe trupave tjera ushtarake të Ilirisë, e kishte emëruar të vëllain e Agronit, Skërdiladiesin (Skërdilaidesi) i cili dikur më vonë, njërën pas tjetrës do i merrte nën kontroll Eliden, Mesinën, si dhe vendet ose qytetet tjera bregdetare të Korintit, Korfuzit dhe Adratikut. Sipas ideve, teorive, koncepteve dhe definicioneve të njohura feministe: “Duhet hedhur poshtë idetë ose teoritë e ndryshme maskiliste ose paternaliste, që kanë për qëllim limitimin ose përkufizimin e sferës intelektuale, profesionale dhe politike mbi bazat e ndryshme gjinore ose seksiste etj. Politika, shteti dhe pushteti sipas tyre, janë diçka përtej kuzhinës ose shtratit (krevatit) bashkëshortor ose martesor. Ndaj, mu për shkak të asaj se forca ose fuqia politike, sipas teorisë dhe praktikës së njohur feministe “janë shpikur ose zbuluar nga gjinia mashkullore si qëllime, mjete ose instrumente të kontrollit, monopolit, sundimit, komplotit, shantazhit dhe manipulimit”, atëherë, gjithnjë femrave (grave) të forta (fuqishme), markante, inteligjente dhe feministe: Shkenca dhe politika aq sa janë çështje ose aspekte të logjikës, njohjes, përvojës dhe aftësisë, po aq janë edhe çështje ose aspekte të sistemit ose mekanizmit të autoritetit, forcës ose fuqisë materiale, ligjore, fizike (organike), politike etj.

Ndonëse, modernizmi ose postbiheviorizmi, pos tjerash i kanë determinuar, paradigmaturuar, fragmentarizuar dhe relativizuar edhe dallimet dhe pozicionet e ndryshme (metateorike, normative, ontologjike, epistemologjike, gnoseologjike, kritike, dialektike, materialiste, idealiste, empirike, intinznike, ekstrinznike, racionale ose logjike etj.) në mes atyre që lindin, krijojnë ose prodhojnë dhe atyre që munden, dinë dhe fitojnë. Kohëve të fundit gruaja (femra) intelektuale dhe inteligjente është futur ose ka depërtuar në të gjitha fushat ose segmentet e mundshme të jetës. Në familje, shoqëri, arsim, shkencë, kulturë, informim, ekonomi, industri, tregti, ushtri (armatë), polici, politikë, diplomaci etj. Duke u angazhuar dhe kontribuar kështu për shëndetin, rritjen, zhvillimin, përsosjen, eksplorimin, afirmimin dhe avancimin e gjithmbarshëm dhe sa më të shpejtë të njeriut, popullit (kombit), shtetit dhe shoqërisë së gjerë njerëzore ose qytetare në kuptimin e plotë të fjalës. Kjo për faktin se edukata, kultura, arsimimi, emancipimi, intelektualizmi, profesionalizmi, vlerat, lufta, konkurrenca dhe



patriotizmi, në esencën ose substancën e tyre janë integral, në aspektin njerëzor ose qytetar-global ose universal, të rëndësishëm dhe karakteristik për çdo qenie ose specie njerëzore, për çdo racë ose gjini. Ky realitet është padyshim aperiënt, empatik dhe transparent, për sa kohë që femra (gruaja) intelektuale, profesionale ose inteligjente, jeton, punon, krijon, mendon dhe është valide, ose e barabartë dhe relevante me të tjerët në arenën botërore ose ndërkombëtare që nga Antika dhe deri më sot. Ndaj, edhe forcat ose energjitë e njohura racionale e kritike të pranishme në konceptin elitär dhe egalitär të kulturës shtetërore dhe nacionale, do duhej të

vendoseshin kundër funksionit të palës kundërshtare antropologjike, antropolitike ose antropobiologjike që ka për qëllim mohimin, përjashtimin, stigmatizimin, anashkalimin ose paragjykimin e gjinisë së bukur. Në instancë të fundit, rrymat, tendencat ose lëvizjet e ndryshme feministe ose iluministe të gjinisë së bukur ose “polit të butë” i bëjnë mirë popullit, shtetit, pushtetit, arsimit, shkencës, kulturës, informimit, politikës dhe diplomacisë etj. E sidomos atëherë kur ka tentativa serioze për të kthyer tërësinë e mendimit kritik në një institucion ose instancë të lartë morale dhe kompetente që e bën të pamundur përthithjen, relativizmin ose



“ASKUSH NË KËTË BOTË NUK GUXON DHE S’KA TË DREJTË ME E PENGUAR LUNDRIMIN E ANIJEVE DETARE, TREGTARE OSE USHTARAKE TË ILIRISË NË DETET E LIRA TË EGJEUT, JONIT DHE ADRIATIKUT!”

inkuadrimin e tyre si “vegla pune”, apo si vlerë këmbimi. Në fund të fundit, gjithçka që është e bukur, e dashur, e mençur dhe fisnike, është fryt i vetëdijes, ndërgjegjes, arsyes, kulturës dhe edukatës. Nuk na kanë faj Teuta dhe femrat ose gratë tjera shqiptare, pse janë aq të bukura, të mençura, të dashura, inteligjente, intelektuale, profesionale, temperamente, ekskluzive, ekzotike dhe feministe. Jo! Kur e pyetën njëherë një mbret ose perandor romak se ku ndodhej mesi ose kërthiza e botës, pa u menduar fare tha: “Ku tjetër, pos aty, në Risan (Rizzon) ku Teuta e bukur, inteligjente, pirate, luftarake, me temperament dhe ekstravagante nga Iliria, i derdh ëndrrat dhe shtatin (trupin) e saj valë në shtrat!”. Përderisa, bashkëshorten e bukur dhe krenare të luftëtari dhe komandantit të njohur ilir, thuhet se e mashtruan me lajmin e rrejshëm mbi vdekjen (rënien) e bashkëshortit të saj në fushën e nderit, duke ia çuar këmishën e shqyer dhe të përgjakur të burrit të saj që e kishte hedhur ose harruar në front, por heroína hilite i dha fund jetës aty për aty

vetëm që të mos u binte e gjallë në duar ushtarëve dhe komandantëve romak. Ndërsa, burri i saj u hakmor keq për bashkëshorten e tij dikur me vonë. E drejta, liria, barazia dhe pavarësia e njohur ligjore, gjinore, racore, shtetërore, nacionale, etnike, profesionale, institucionale, funksionale, klasore, sociale, kulturore, historike dhe politike, së bashku me lëvizjet e njohura feministe dhe të tjera, kanë qenë objekt i studimeve, analizave dhe interpretimeve të njohura shkencore ose metodologjike që nga etapat ose periudhat e njohura revolucionare, para-revolucionare ose post-revolucionare dhe deri më sot. E sidomos feminizmi, i cili në fillim, më tepër ishte si të thuash organizatë ose lëvizje politike, se sa koncept ose pozicion i definuar shkencor ose humanist në mënyrë praktike dhe teorike. Ndërkaq, me kyçjen, angazhimin, përfshirjen, inkorporimin dhe insubordinimin e grave (femrave) të njohura feministe në botën dhe jetën e përgjithshme politike, shkencore, kulturore ose akademike, do bëhen valide dhe relevante kritikrat dhe teoritë e njohura shkencore

dhe humaniste, jo vetëm ndaj shteteve, sistemeve dhe shoqërive të ndryshme liberale, parlamentare dhe demokratike, por edhe ndaj teorive të ndryshme determinante dhe paradigmatiske në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, informimit dhe politikës, diplomacisë etj. Sidomos në Angli, Francë, SHBA dhe vende tjera nëpër etapat ose periudhat e ndryshme revolucionare, post-revolucionare, bihevoriste, post-bihevoriste etj. Ndaj, sipas ideve, teorive, koncepteve dhe definicioneve të njohura feministe: “Duhet hedhur poshtë idetë ose teoritë e ndryshme maskiliste ose paternaliste që kanë për qëllim limitimin ose përkufizimin e sferës intelektuale, profesionale dhe politike mbi bazat e ndryshme gjinore ose seksiste etj. Politika, shteti dhe pushteti, sipas tyre, janë diçka përtej kuzhinës ose shtratit (krevatit) bashkëshortor ose martesor. Duke menduar në rendin ose sistemin e njohur shkencor dhe humanist ose gnoseologjik-epistemologjik të edukatës dhe kulturës së gjithmbarshme shtetërore, nacionale, familjare, gjenealogjike, institucionale, politike, kulturore, historike, gjeografike etj. Dhe, mu për shkak të asaj se forca ose fuqia politike, sipas teorisë dhe praktikës së njohur feministe, janë shpikur ose zbuluar nga gjinia mashkullore si qëllime, mjete ose instrumente të kontrollit, monopolit, sundimit, komplotit, shantazhit dhe manipulimit”, atëherë, gjithnjë sipas tyre, shkenca dhe politika aq sa janë çështje ose aspekte të logjikës, njohjes, përvojës dhe aftësisë, po aq janë edhe çështje ose aspekte të sistemit ose mekanizmit të autoritetit, forcës ose fuqisë materiale, ligjore, fizike (organike), politike etj. Ndonëse, modernizmi ose postbieheivorizmi, pos tjerash i kanë determinuar, paradigmaturuar, fragmentarizuar dhe relativizuar edhe dallimet dhe pozicionet e ndryshme (metateorike, normative, ontologjike, epistemologjike, gnoseologjike, kritikie, dialektike, materialiste, idealiste, empirike, intinznike, ekstrinznike, racionale ose logjike etj.) në mes atyre që lindin, krijojnë ose prodhojnë dhe atyre që munden, dinë dhe fitojnë. Kohëve të fundit gruaja (femra) intelektuale dhe inteligjente është futur ose ka depërtuar në të gjitha fushat ose segmentet e mundshme të jetës. Në familje, shoqëri, arsim, shkencë, kulturë, informim, ekonomi, industri, tregti, ushtri, polici, politikë, diplomaci etj. Duke u angazhuar dhe kontribuar kështu për shëndetin, rritjen, zhvillimin, përsosjen, eksplorimin, afirmimin dhe avancimin e gjithmbarshëm dhe sa më të shpejtë të njeriut, popullit (kombit), shtetit dhe shoqërisë së gjerë njerëzore ose qytetare në kuptimin e plotë të fjalës. “Shqiptarët kanë kodin e vet moral, luftarak dhe patriotik, dhe janë të besueshëm e patriotë, deri në vdekje!”, do thoshte dikur H. Charles Woodsi. Shqiptarët janë popull (komb), kulturë dhe civilizim i veçantë. Edhe gjuha, kultura, lufta dhe historia e tyre është e veçantë ose specifike. Shqiptarët janë popull trim, tolerant, bujar dhe tepër fisnik, të cilët edhe në kohë lufte ose konfliktesh dhe armiqësisë të ndryshme me të tjerët, ua njohin, ua ruajnë (mbrojnë) dhe respektojnë varret, flitë, hyjnitë, ritualet, kishat, manastiret ose objektet e ndryshme të kultit, fesë (religjionit), nderin, moralin, traditën dhe kështu me radhë, njerëzve dhe popujve të tjerë. Së këndejmi, edhe gjatë kohës së luftës së fundit, dhe pas luftës në Kosovë, shqiptarët nuk e dogjën, nuk e prishën ose nuk e shkatërruan asnjë kishë ose manastir serb në Kosovë. Nuk e prishën ose rrënuan asnjë varr të tyre etj. Absolutisht jo! Madje, fisnikët ose trimat e njohur shqiptar, edhe gjatë luftërave të mëdha botërore ose ballkanike, thuhet se i kanë marrë në besë, strehuar, mbrojtur dhe shpëtuar serbët dhe të tjerët. Nga kjo rezulton se fizionomia, identiteti, dinjiteti (dinjiteti), autenticiteti, ekskluziviteti, sovraniteti dhe integriteti i njeriut ose popullit (kombit) shqiptar, në esencën ose substancën e tyre, konsistojnë në lirinë, nderin, moralin, respektin dhe konsideratën maksimale ose optimale ndaj palës tjetër. Është në nderin, moralin, kulturën dhe traditën e njohur të Gjergj Kastriotit dhe Lek Dukagjinit që të mos merret gjak, ose të mos vritet hasmi ose gjakësori, nëse e ka një grua (fëmër) ose fëmijë (kalama) të vogël me veti. Apo, nëse fëmijët dhe familja e tij, nuk kanë miell në magje ose bukë në sofër. Ndërkohë që shqiptarët e vërtetë përveç Zotit (Hyjit), nuk njohin “figura supreme” ose “madhështore” që i “zotërojnë” ose “komandojnë” edhe “mbretëritë e yjeve” së bashku me gjëmimet e motit ose bubullimat e qiellit! Shqiptarët e vërtetë dhe patriotë, nuk i njohin dhe s’i pranojnë kurrë kokat e përlulura dhe fare bosh, që nuk i pret kurrë tehu i shpatës së mbretit ose sulltanit! E sidomos kokat e përlulura ose nënshtruara, ku zgjatet ose shtrihet qafa e tyre jo kurrizore, poshtë krahut të së cilës prehen tabelat e ligjeve së bashku me gjeometrinë ose gjeografinë e stisur të varrit dhe natës së fundit mbi tokë.

Jo kurrë e kurrës. Absolutisht kurrë!

Resul Bedo, "Yjet e Pashuar", rrugëtim në dy epoka

Resul Bedo, është ushtaraku shqiptar më i spikatur si autor i shumë botimeve. Ai ka lindur në vitin 1926, në fshatin Fushë-Bardhë të Gjirokastrës. Në moshën 15-vjeçare, ai ishte nga të parët që u rreshtua në çetën "Çerçiz Topulli", më pas në batalionin "Asim Zeneli" dhe më vonë në Brigadën e 6 Sulmuese. Gjatë luftës mori pjesë edhe në betejat në Jugosllavi. Ndërsa pas çlirimit të vendit do të ishte nga ushtarakët që morën pjesë në përballjet me Greqinë gjatë provokacioneve në kufi, më vitin 1948.

Resul Bedo ndërroi jetë në moshën 91-vjeçare, si shkrimtar dhe publicist i njohur. Ai ka të botuar mbi 100 tituj librash, ndër të cilët 19 kanë të dokumentuar jetën e dëshmorëve shqiptarë të rënë në Luftën e Dytë Botërore, nën titullin "Yje të Pashuar".

Për një kohë të gjatë ai ka shërbyer si ushtarak karriere në ushtri dhe gjithashtu për shumë vite ka shërbyer në sektorin e kulturës në Ministrinë e Mbrojtjes dhe ka mbajtur gradën "kolonel". Duke ushtruar paralelisht pasionin dhe talentin e tij të madh për të shkruar, ai ka zhvilluar një aktivitet të dendur në krijimtarinë e tij letrare. Krijimtarinë e tij e nisi që në moshë të re në botimet e shtabeve të ushtrisë, për t'u bërë më pas një nga autorët më të zëshëm të historisë së luftës dhe heronjve të saj. "Duam apo s'duam ne, dëshmorët janë të bashkuar. Ata kanë rënë për një qëllim të përbashkët, për kombin shqiptar, për lirinë dhe demokracinë", është shprehur ai për "Yjet e Pashuar" të botimeve të tij, teksa ata qëndrojnë të gjithë së bashku në rreshta, duke dëshmuar historinë.

Që në vitet e Luftës Resul Bedo ka tentuar të shkruajë rreth asaj që i mbetej në kujtesë. Nga ajo kohë kanë mbetur ende disa gjurmë. Edhe pse kishte një dëshirë të madhe për të shkruar, pas çlirimit "punët nuk ishin të lehta". Ushtria partizane ku ai ishte inkuadruar duhej të kthehej në një ushtri moderne, por ai përkrah detyrimeve ushtarake, bënte diçka dhe në fushën e letrave. Letërsia e tërhiqte fort dhe e ngacmonte për të shkruar, madje filloi edhe të botonte. Vëllimet e para ishin me tregime për Luftën, si "Shqiponjat e vogla", "Ditar partizan", "Në grykën e Zarelit", "100 episode partizane". Më pas shkroi romanin "Edhe ne luftuam", me të cilin fitoi dhe çmimin e parë në konkursin kombëtar, por botimet me tregime kanë qenë të vazhdueshme. Resul Bedo ka shkruar edhe në gjininë e novelës, por gjithmonë me tematikë nga lufta. Ka shkruar romanet "Furtuna", "Ndëshkimi i korbave", "Goditja", "Bilbilenjtë" etj.



"Yje të pashuar", si lindi titulli i librit që tregon lavdi

Dëshmorët e atdheut dhe heronjtë e kombit, siç është shprehur vetë Resul Bedo, kanë qenë objekt i punës së tij thuajse të përher-shme, duke filluar që në vitet e Luftës. "Megjithëse unë kam shërbyer në detyra komanduese në ushtri, gjithnjë më ka ngacmuar çështja e dëshmorëve. Kështu grumbullova materiale të shumta si në rastin e botimit "100 episode partizane", ku të gjithë ishin me fotografi. Pastaj, duke shkruar vazhdimisht, si "Shqiponjat e vogla" e të tjera tregime, vura re se u bënë një sasi e madhe. Atëherë mendova t'i hidhja në një vëllim", ka thënë ai. Autori ka treguar se si në një Përvjetor të Çlirimit kishte përgatitur për shtyp botimin, duke e titulluar "Krahët e shqiponjës". "Mu duk si një titull tepër i gjetur, duke u bazuar në fjalët e Pirros së Epirit, që u tha ushtarëve, nëse ju më quani mua shqiponjë, ju ishit krahët e mi".

Më tej në rrëfimin e tij ai thotë se ishte pikërisht një mik i tij që i kishte bërë vërejtje kur kishte parë vëllimin para se ai ta çonte në shtyp, duke i thënë se "Këta dëshmorë janë të vranë të gjithë dhe krahët e shqiponjës s'mund të fluturojnë. Mos të krijon ndonjë keqkuptim një gjë e tillë?". Dhe kishte qenë kjo vërejtje miqësore që e bëri autorin "të zmbropsej" dhe të ndërronte titullin me atë që njohim sot "Yje të pashuar". Materiali ishte i shumtë, kështu që u desh të dilnin dy vëllime me të njëjtin titull. Ishte e para herë që përdorej në mjetet e informacionit një shprehje e tillë. "Në fillim mendoja se si do kapej kjo nga lexuesit, si do të reflektonte ai, si do ta priste botimin tim. Por interesante ishte se ai titull u përshat shumë shpejt dhe u bë i plotfuqishëm. Kjo gjë më dha dorë. Vazh-dova të punoja sërish dhe kjo solli për rrjedhojë dhe botimin e katër vëllimeve të tjera", tregon autori.

Ndërkohë të dy vëllimet u dërguan për t'u botuar në Kinë, për një cilësi maksimale. Në atë kohë Kina i jepte Shqipërisë tanke, aeroplanë, armatime, prandaj dhe shtypja dhe dalja në dritë e dy

vëllimeve me cilësi të lartë, sigurisht që do të ishte një realizim i sigurt. Kurse më pas shtypshkronja erdhi në Shqipëri dhe nuk doli asnjë problem me cilësinë e botimit të vëllimeve të tjera. Pra dy vëllimet e para "Yjet e Pashuar", janë shtypur në Kinë, për shkak të cilësisë së lartë që duhej për të përballuar luksin e këtij libri, ndërsa 4 vëllimet e tjera në Tiranë.

Materiali i përzgjedhur dhe botimi

Për hartimin e katër vëllimeve të librit autori ka hulumtuar në të gjithë Shqipërinë, duke grumbulluar materialin e nevojshëm, prova dhe fakte, ku morën pjesë dhe shumë familjarë të dëshmorëve të Luftës, të cilët i sillnin materiale konkrete. Kjo gjë bëri të mundur që ushtaraku Resul Bedo të dilte tashmë si shkrimtar i lirë, ku më vonë u angazhua edhe në Komitetin Kombëtar të Veteranëve.

Por pikërisht kur u realizuan 6 vëllime, botimi i "Yjeve të Pashuar" u ndërpre dhe sipas asaj që ka dëshmuar autori, kjo ndërprerje "ishte e padrejtë" dhe se "burokracia e kishte bërë punën e saj", duke krijuar probleme nga më të ndryshmet. Ndërkohë që u duk sikur lexuesi dhe opinioni u kënaq me 6 vëllime, ndërsa për autorin ato nuk ishin mjaft, pasi ai synonte më tepër, "në atë kohë kërkoja të realizoja botimin e 10 vëllimeve", është shprehur ai.

Dhe ndërsa ka folur për ndalimin e botimit, ai ka treguar se "të dhënat i merrte nga baza" dhe familjet kishin dëshmi autentike. Madje për këtë Ministria e Mbrojtjes i kishte vendosur në dispozicion 2-3 ushtarë, me prirje letrare, të cilët e ndihmonin atë për të seleksionuar materialet. Por në këto të dhëna ndonjëherë vihej re se diçka nuk shkonte. "Ishte propaganduar tjetër gjë, por dilte tjetër gjë. Të vogla në dukje, por udhëheqësit nuk mund t'i toleronin, përderisa gjërat kishin ndryshuar dhe nga gjiri i partisë kishin dalë 'grupet e tradhtarëve'". Ky ishte dhe shkaku dhe u mendua që botimi i "Yjet e Pashuar" të ndalej me kaq.

E ndërsa botimi ishte iniciativa e autorit nuk mund të thuhet se udhëheqja e asaj kohe ishte indiferente, pasi ajo dinte gjithçka që botohej, e aq më tepër një botim i tillë. Sapo u njoh me materialin, vetë kreu i shtetit dhe qeverisë të kohës tregoi interes për të dhe kërkoi që, nëse dilte ndonjë vëllim i ri, t'i vihej menjëherë në dispozicion. Ai e ndiqte më vëmendje serinë e këtij botimi, por pas vitit 1985, kur dhe Enver Hoxha nuk jetonte më, botimi u pezullua.

Resul Bedo ka treguar se vështirësia më e madhe ndodhi pas vitit 1974, kur doli i ashtuquajtur "grupi puçist në ushtri", ku u rrëzuan shumë materiale të grumbulluara, u censuruan shumë emra, si dhe shumë fotografi e materiale të tjera u shkatërruan. Ndërkohë ai vetë mori "vërejtje" në organizatën bazë.

Megjithëse lidhur me botimin kishte dashamirësi nga publiku dhe udhëheqja në tërësi gjithashtu, (përndryshe nuk mund të bëhej i mundur botimi), iniciativa ishte dhe mbeti e autorit. Ndërkohë ai nuk kishte asnjë të drejtë mbi librin pas daljes nga botimi apo asnjë privilegj dhe ashtu siç botoheshin edhe librat e tjerë, botohej

dhe "Yjet e Pashuar". Ndërsa mos botimi disavjeçar i librit krijoi përshtypjen se nuk do të kishte më vazhdimësi, botimi "Yjet e Pashuar" rifilloi, dhe në vitin 1996 u bë e mundur dalja e vëllimit të 7-të. Rifillimi i ciklit pas rreth 10 vitesh ndërprerje, krijoi sërish interesin edhe pse deri në atë kohë ishte menduar se nuk do të kishte më "Yje të Pashuar".

Financimi, shifrat, të rënë dhe viktimat e Luftës, Shqipëria një dëshmor në çdo kilometër

Nëse 6 vëllimet e para merreshin përsipër të botoheshin nga vetë shteti i centralizuar, në periudhën post komuniste gjithçka ndryshoi. Botimi i "Yjet e Pashuar" ose duhet të sponsorizohet ose financimi duhet të dalë nga shitja, sipas asaj që dikton ekonomia e tregut. Por duket se asnjëra prej tyre nuk ndodhi. "Më e rënda nga të gjitha, ka qenë zgjidhja e çështjes financiare", është shprehur autori dhe botimi i vëllimeve është bërë në mënyrë vullnetare, me pak ndihmë nga shtypshkronja, apo me shitjet. Ndërkohë që materiali i gatshëm pret për botim, i cili është përzgjedhur tashmë, vëllimi i fundit i botuar është një vëllim i veçantë në serinë "Yjet e Pashuar". Ai ka në përmbajtje 70 ushtarë e oficerë të vranë në provokacionet greke të gushtit '49.

Por një nga çështjet e debatuar mes forcave politike në fillim të demokracisë shqiptare ka qenë dhe shifra e dëshmorëve të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore, pasi për numrin e dëshmorëve, forcat politike nuk gjenin gjuhën e përbashkët. Shifra që sundoi për 40 vjet ishte ajo e 28 mijë dëshmorëve, që personifikonin dhe 28 mijë kilometrat katrorë të shtetit shqiptar. Ndërsa në periudhën postkomuniste u deklarua se dëshmorët nuk kishin qenë më shumë se 12 mijë, madje ishin në shifrat e 8-mijë të rënëve. Për këtë shkrimtari Resul Bedo, si njohës i mirë i çështjes ka thënë se: "Për dëshmorët ka pasur vërtet një farë sektarizmi. Fillimisht u mendua të shpallehin dëshmorë ata që ranë në betejë. Por në fakt janë po aq dëshmorë dhe ata që u pushkatuan. Sepse ka pasur të vranë dhe nga bombardimet e aviacionit. Jo vetëm nga ai pushtues, por dhe nga aviacioni aleat. Kështu lindnin problemet. U tha se ata nuk janë vranë me armë në dorë. Flitet për 28 mijë dëshmorë. Në fakt unë kam lexuar materialet e prefekturave të atëhershme, të cilat i dërgonin në formë relacioni emrat e të rënëve për çdo rreth. Pastaj këto lista (të cilat gjenden në arkiva) filluan të cungheshin padrejtësisht. Por unë mendoj se është bërë një padrejtësi me ta. Kështu që, them se janë 28 mijë dëshmorë. Kjo shifër është bërë e njohur tashmë. Sepse ka ndodhur që flasin për shifra e për numërime ata që nuk janë marrë ndonjëherë me këtë punë. Por në fakt ne mburremi dhe themi që gjatë Luftës ishim përkrah aleatëve tanë antifashistë. Por dhe aleatët e mëdhenj mburren me dëshmorët e tyre. Dhe këta dëshmorë ata i bëjnë personazhe nëpër vepra e filma. Pra, u japin vendin që meritojnë. Unë vetë në librat e mi kam publikuar rreth 5.000 dëshmorë, por kam dhe shumë të tjerë që nuk janë publikuar", ka shpjeguar autori i serisë së botimit "Yje të Pashuar".





Ushtria e Mbretërisë së Bashkuar ka lëshuar satelitin e parë të dedikuar për imazhet e Tokës. E quajtur “Tyche”, anija kozmike do të ketë rezolucion të mjaftueshëm për të identifikuar pozicionet e trupave dhe automjeteve në fushën e betejës. Ky është i pari që do të ndiqet nga një rrjet satelitesh këtë dekadë, që përdorin një shumëllojshmëri sensorësh. Disa nga këto anije kozmike të ardhshme do të jenë në gjendje të përgjojnë transmetimet e radios apo të shohin sipërfaqen e Tokës në çdo mot si dhe gjatë natës, një veçori që Ukraina e ka pasur thelbësore në gjurmimin e forcave pushtuese ruse. Misioni britanik do të rrethojë globin në një lartësi prej rreth 500 km, ku pritet të operojë për të paktën pesë vjet. Forcat e Mbretërisë së Bashkuar kanë përfutur prej kohësh nga përdorimi i sistemit të tyre të komunikimit satelitor më të avancuar, të quajtur “Skynet”, por marrja e aksesit në imazhet e vëzhgimit nga hapësira ka ardhur duke u kërkuar një leje miqësore aleatëve, veçanërisht Shteteve të Bashkuara. Edhe pse Ministria e Mbrojtjes ka kontribuar me fonde në të kaluarën për projekte në sektorin tregtar në Mbretërinë e Bashkuar, “Tyche” do të jetë i pari në pronësi të plotë. Sateliti 160 kg do të mbledhë imazhet e tij në gjatësi vale optike, në të njëjtën dritë që ndiejmë me sytë tanë. Është projektuar për të kapur skena 5 km të gjera në tokë dhe ka një rezolucion maksimal prej 90 cm. Kjo nuk është aspak performanca më e mirë e mundshme, pasi disa satelitë amerikanë raportohet se shohin veçori të vogla deri në 10 cm, por megjithatë përshtatet me nevojat e përgjithshme të ushtrisë britanike. “Tyche” lindi nga një Dokument i Komandës Hapësinore të vitit 2021 dhe një Strategji e Mbrojtjes Hapësinore të vitit 2022, e cila detyroi qeverinë e fundit të shpenzonte 970 milionë paund gjatë 10 viteve.



Australia miraton planet për “fushën më të madhe me panele diellore në botë”, zbulohen detajet e para

Australia miratoi planet për një “fushë masive me panele diellore dhe baterish” që do të eksportonte energji në Singapor, një projekt i konsideruar si “zona më e madhe diellore në botë”. Autoritetet njoftuan miratimet mjedisore për projektin 24 miliardë dollarësh të “SunCable” në veriun e largët të Australisë, i cili është planifikuar të furnizojë me energji tre milionë shtëpi, shkruajnë mediat e huaja. Projekti, i cili do të përfshijë një sërë panelesh, baterish dhe, përfundimisht, një kablo që lidh Australinë me Singaporin, mbështetet nga miliarderi i teknologjisë dhe aktivisti i gjelbër Mike Cannon-Brookes. “Do të jetë zona më e madhe solare në botë, dhe kjo e bën Australinë si lider botëror në energjinë e gjelbër”, tha ministria e Mjedisit, Tanya Plibersek. Shpresohet që prodhimi i energjisë të fillojë në vitin 2030, duke siguruar katër gigavat energji për përdorim shtëpiak. Dy gigavat të tjera do të dërgoheshin në Singapor përmes kablove nënujore, duke furnizuar rreth 15 për qind të nevojave të qytetit-shtet. Drejtori menaxhues i “SunCable” Australia, Cameron Garnsworthy tha se miratimi ishte “një moment historik në rrugën e projektit”. Por, procese të shumta miratimi dhe pengesa të tjera mbeten pavarësisht dritës jeshile të së mërkurës. Projekti varet nga nënshkrimet nga autoriteti i tregut të energjisë të Singaporit, qeveria e Indonezisë dhe komunitetet indigjene australiane.



Barack dhe Michelle Obama elektrizojnë demokratët, mbështesin fuqishëm nënpresidenten Harris

Ish-Presidenti amerikan Barack Obama iu drejtua demokratëve në Kuvendin Kombëtar, duke thënë se nënpresidentja Kamala Harris është zgjidhja e duhur për të sfiduar ish-Presidentin Donald Trump në zgjedhjet e nëntorit. Siç njofton korrespondentja e Zërit të Amerikës, Katherine Gypson, ish-Presidenti dhe bashkëshortja

Britania lëshon satelitin e parë ushtarak, do përdoret për të identifikuar trupat në betejë



e tij Michelle ishin folësit kryesorë të natës së dytë të Kuvendit në Çikago. Një pritje entuziaste në Kuvendin Kombëtar Demokrat për ish-Presidentin Barack Obama. “Amerika është gati për një kapitull të ri. Amerika është gati për një histori më frymëzuese. Ne jemi gati për një Presidente Kamala Harris”, - tha zoti Obama. Ai vuri në pah kontrastin mes nënpresidentes Harris dhe rivalit të saj republikan, ish-Presidentit Donald Trump. “Kamala Harris nuk do të mendojë vetëm për veten e saj. Ajo do të përqendrohet tek ju. Si presidente, ajo nuk do të kujdeset vetëm për mbështetësit e saj dhe të ndëshkojë ata që nuk janë dakord me të. Ajo do të punojë në emër të çdo amerikan – kjo është Kamala”. Zoti Obama u prezantua nga gruaja e tij Michelle, e cila në fjalimin e saj tha se në kohën e shkurtër deri në zgjedhje, demokratët duhet të bëjnë fushatë intensive për zonjën Harris. “Nuk mundet thjesht të vrasim mendjen nëse ky vend do të zgjedhë dikë si Kamala. Duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për të zgjedhur dikë si Kamala”, - tha zonja Obama. Megjithatë procesi i emërimit të zonjës Harris si kandidate u bë në fillim të këtij muaji, një apel ceremonial i votave të shteteve, tregoi entuziazmin e demokratëve për të. Nënpresidentja Harris falënderoi delegatët nga distanca nga një tubim zgjedhor në Miluoki të Viskonsinit. Një nga folësit e mbremjes ishte edhe bashkëshorti i saj, Doug Emhoff, i cili e quajti gruan e tij një luftëtare optimiste. “Ajo do të udhëheqë me bindjen se pavarësisht nga origjina jonë apo cilit grup i përkasim, ne jemi më të fortë kur luftojmë për atë që besojmë, jo vetëm kundër asaj që i druhami”, - tha ai.



Si e ndryshoi hartën e Europës ura më e lartë në botë?

E shtrirë në një peizazh përrallor, ajo është pa diskutim një prej urave më të bukura në botë. Shpesh e mbështjellë nga mjegulla, aq sa të duket sikur po kalon mes reve, është aq e famshme sa që ka një qendër vizitorësh të veten dhe njerëzit planifikojnë udhëtime turistike vetëm e vetëm që të kalojnë mbi të. Madje, ura mund të shihet lehtësisht edhe nga hapësira. Bëhet fjalë për “Millau Viaduct”, shembulli i përsosur i bashkimit të inxhinierisë me artin. E ngritur mbi grykën Tarn në Francën e jugut, e gjatë 2460 metra, Millau Viaduct është ura më e lartë në botë, plot 336,4 metra. Por këto shifra nuk mjaftojnë për të përmbledhur madhësitinë e saj. Ndryshe nga ura të tjera të famshme, që zakonisht lidhin dy pika të së njëjtës lartësi, Millau Viaduct luhatet nëpër luginë teksa toka poshtë këmbëve të saj merr forma të ndryshme. Shtatë kalatat e saj kanë lartësi të ndryshme, duke nisur nga 78 e deri në 245 metra lartësi, secila e llogaritur me përpikëri milimetrike për ta niveluar urën në përsosmëri. Ato

përforcohen nga shtatë shtylla çeliku, secila 87 metra e lartë, të kapura me nga 11 kablo nga secila anë. E gjithë kjo mban rrugën - 4,2 metra e trashë dhe me peshë 36 mijë tonë - tërësisht të qëndrueshme. Por përveç se një vepër e precizonit të lartë, ura është gjithashtu e bukur. Edhe pse është ngritur në një zonë të mbrojtur, ura vetëm sa e amplifikon bukurinë e saj. Sipas David Knight, drejtor i dizajnit dhe inxhinierisë në kompaninë “Cacke Industries”, thotë se ura është “një prej mrekullive të botës moderne” dhe “mrekulli inxhinierike”. Ata që jetojnë në luginën poshtë saj shohin lart me adhurim, ata që kalojnë anash saj, në një prej autostradave kryesore që lidh jugun me veriun e Francës. Por si ndodhi që kjo mrekulli e botës moderne të ndërtohet në mes të Francës. Pse u deshën dy dekada për ta planifikuar, para se të hapej për kalim në dhjetor 2004? Dhe si arriti kjo urë ta ndryshojë hartën e Europës? Përgjigjja ndaj këtyre pyetjeve është gjeografia. Masivi Qendror është një zonë e madhe malore që ndahet nga lugina dhe gryka të thepisura, që zënë afërsisht 15% të sipërfaqes totale të Francës. I kufizuar nga Alpet në lindje, është një prej zonave më të vështira për të udhëtuar për këdo që kërkon të përshkojë Francën nga veriu në jug, apo për këdo që dëshiron të udhëtojë nga veriu i Europës për në Spanjë.

Kaq i rëndësishëm është ky rrugëkalim, por gjithashtu aq i vështirë, sa që u deshën dy dekada për ta planifikuar e ngritur në këmbë, të paktën sipas Michel Virlogeux, inxhinierit që drejtoi punimet që nga nisja e tyre, në vitin 1987. “Problemi i parë nuk ishte se ura duhej ndërtuar, por ku do të kalonte ajo”, - thotë ai. Asokohe, Masivi Qendror ishte një zonë e largët, pavarësisht se ndodhej në qendër të vendit. Kishte një hekurudhë të vetme që e përshkonte dhe rrugët e tjera ishin në gjendje të keqe. “E gjithë pjesa qendrore e Francës nuk do të mund të zhvillohej për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore”, - thotë Virlogeux. Kështu që në vitet 1980, qeveria franceze vendosi të modernizojë rrjetin rrugor, për të shmangur trafikun e rënduar që krijohet aty nga rrugët e ngushta dhe radhët kilometrike të makinave që kërkonin të zbrisnin në luginë. “Ishte si një njollë e zezë për turistët”, - thotë Emmanuelle Gazel, krye bashkiakja e sotme e qytezës Millau. “Kishte bllokime në trafik, me kilometra. Një imazh shumë i shëmtuar për zonën tonë. Edhe vendasit mezi arrinin të lëviznin”. Virlogeux thotë se vendimi për të ndërtuar një urë aty u mor në shtator 1986, por kishte një problem, gjeografia e zonës nuk linte shteg për një zgjidhje të lehtë. “Na u deshën 3 vjet për të gjetur një zgjidhje”, - thotë ai. Ekspertët u vunë në punë. Gjeologë, gjeoteknologë, inxhinierë rrugësh dhe Virlogeux, i cili deri atëherë kishte në CV-në e tij urën këmbësore të Normandisë, që kalonte mbi lumin Senë në krahinën me të njëjtin emër. Por edhe pse detajet teknike u zgjidhën, qeveria franceze kërkonte që dizajni të ishte gjithashtu i nivelit të parë. Për këtë u hap një konkurs dhe në vitin 1996 atë e fitoi grupi i drejtuar nga Virlogeux dhe arkitekti britanik Lord Norman Foster. Puna më e vështirë ishte bindja e banorëve vendas se ura nuk do të shkatërronte zonën e tyre të mbrojtur, por madje do ta zbuluronte edhe më shumë atë. Pasi u zgjidh edhe ky problem, puna për ndërtimin e urës nisi në tetor 2001. Projekti kushtoi 400 milionë euro dhe u përdorën 290 mijë tonë çelik e beton, ndërsa punuan 600 punëtorë.

Ushtria Amerikane do t'i bashkohet betejës nëse ndonjë prej këtyre vendeve shkon në luftë

Pas dy luftërave botërore shkatërruese, disa vende evropiane u lanë në gërmadha, duke humbur afërsisht 36.5 milionë banorë të tyre. Për të parandaluar konfliktet e ardhshme, Mbretëria e Bashkuar dhe Franca formuan një aleancë mbrojtëse në vitin 1947. Në vitin 1949, ky pakt u zgjerua duke përfshirë Belgjikën, Luksemburgun, Holandën, Shtetet e Bashkuara, Kanadanë, Portugalinë, Italinë, Danimarkën, Norvegjinë dhe Islandën, kolektivisht e njohur si Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Gjatë 75 viteve të ardhshme, anëtarësimi i NATO-s është rritur për të përfshirë më shumë se 30 vende, me Suedinë duke u bërë shtesa më e fundit në 2024.

Megjithatë, NATO nuk është e vetmja marrëveshje mbrojtëse e mbajtur nga Shtetet e Bashkuara. Në fakt, SHBA-ja është e detyruar me traktat të mbrojtë mbi 50 vende sot.

Paradoksi i Aleancave Amerikane

Që nga fillimi, Shtetet e Bashkuara kanë pasur një qëndrim paradoksal ndaj pjesës tjetër të botës. Nga njëra anë, SHBA-të e shohin veten si një “Qytet në një kodër” - një tokë e lirisë që qëndron si shembull për pjesën tjetër të botës. Nga ana tjetër, kanë pasur një neveri për t'u përfshirë në “ngatërrim aleancash”.

Për pjesën më të madhe të historisë së SHBA-ve, Oqeanet e paanë Atlantiku dhe Paqësori i dhanë Shteteve të Bashkuara një izolim të lumtur nga problemet e Botës së Vjetër. Kjo përfundoi kur Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore treguan se mospërfshirja mund t'i lejojë kërcënimet e huaja të dalin jashtë kontrollit aq sa mund të kërcënojnë Amerikën. Pra, përmes një sistemi aleancash, Shtetet e Bashkuara mbajnë një perimetër të thellë mbrojtës për bregun perëndimor në Azi dhe bregdetin lindor në Evropë. SHBA-të punojnë me aleatët për të penguar rivalët e fuqisë kryesore dhe për të zhvilluar strategji për të kundërshtuar kërcënimet në zhvillim.

NATO

Aleanca më jetike e Shteteve të Bashkuara është Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut. Ajo u themelua në vitin 1949 për të kundërshtuar Bashkimin Sovjetik ekspansionist dhe vazhdon të kundërshtojë ekspansionizmin rus edhe sot. NATO ka ndihmuar në sigurimin e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit të paprecedentë për Evropën. Uniteti i aleancës zgjati më shumë se rivali i saj në Evropën Lindore, Traktati komunist i Varshavës, dhe përfundimisht thithi shumicën e anëtarëve të saj.

Kombet anëtare të NATO-s

Anëtarët e NATO-s sot janë: Shqipëria, Belgjika, Bullgaria, Kanadaja, Kroacia, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Tre vende të tjera kanë shpallur synimin e tyre për t'u anëtarësuar në NATO: Bosnje-Hercegovina, Gjeorgjia dhe Ukraina. Anëtarësimi i Bosnjës është disi problematik për shkak të ndarjeve të thella etnike që kërcënojnë paqen dhe stabilitetin e vendit. Gjeorgjia nuk është plotësisht nën kontrollin e territorit të saj për shkak të ndërhyrjes paraprake të Rusisë në rajonet e diskutueshme dhe Ukraina është aktualisht e përfshirë në një luftë të plotë me Rusinë. Derisa të arrihen marrëveshjet e paqes me Rusinë, dy vendet e fundit nuk kanë gjasa të arrijnë anëtarësimin e plotë në NATO.

Kur NATO-ja mbrojtë një anëtar...

Në nenin 5 të traktatit të NATO-s, vendet anëtare angazhohen që ta konsiderojnë një sulm ndaj secilit prej tyre si sulm ndaj të gjithëve. Hera e parë dhe e vetme që ky traktat u thirr ishte kur Shtetet e Bashkuara u sulmuan më 11 shtator 2001. Aleatët e tjerë të NATO-s ranë dakord se ky ishte një sulm ndaj të gjithëve dhe dolën në mbrojtje të Shteteve të Bashkuara.

Në një shprehje praktike të kësaj mbrojtjeje kolektive, NATO dërgoi 7 avionë të sistemeve të paralajmërimit dhe kontrollit të hershëm ajror (AWACS) nga Evropa në kontinentin e SHBA-së për të patrulluar qiellin dhe për të parandaluar sulme të mëtejshme. I quajtur Operacioni “Eagle Assist”, ky mision zgjati 7 muaj. 830 anëtarë të ekuipazhit nga 13 vende të ndryshme të NATO-s mbrojtën qiellin amerikan për 4300 orë në mbi 360 fluturime operacionale.

Traktati i Rios

Që nga Doktrina Monroe e vitit 1823, Shtetet e Bashkuara i kanë ndaluar vendet evropiane të fillojnë koloni të reja në kontinentin amerikan. Kur Lufta e Ftohtë me Bashkimin Sovjetik filloi pas Luftës së Dytë Botërore, SHBA-të u përpoqën të forconin hegjemoninë e saj në Botën e Re me Traktatin Ndër-Amerikan të Ndihmës Reciproke të vitit 1947. Zakonisht quhet Traktati i Rios ose Pakti i Rios sepse u nënshkrua në Rio de Zhaneiro.

Traktati është një marrëveshje kolektive e mbrojtjes midis Shteteve të Bashkuara dhe mbi një duzinë vendeve të Amerikës Latine, me anë të së cilës një sulm ndaj njërit konsiderohet si sulm ndaj të gjithëve. Megjithatë, ndërhyrjet e shumta amerikane në Karaibe dhe Amerikën Qendrore, si dhe mbështetja e tij për Mbretërinë e Bashkuar gjatë Luftës së Ishujve Falkland me Argjentinën, kanë dëmtuar reputacionin e traktatit me disa nga vendet e rajonit.

Anëtarët e Traktatit të Rios

Anëtarët aktualë të Traktatit të Rios janë Argjentina, Bahamas, Brazili, Kili, Kolumbia, Kosta Rika, Republika Domenikane, El Salvador, Guatemala, Haiti, Hondurasi, Panama, Paraguaj, Peru, Trinidad dhe Tobago, Shtetet e Bashkuara, Uruguai, dhe (ndoshta) Venezuela. Statusi i anëtarësimit të Venezuelës është i paqartë sepse qeveria e saj ka dërguar mesazhe kontradiktore në lidhje me qëllimet e saj.

Ish-anëtarë të Traktatit të Rios

Kuba u pezullua nga traktati në vitin 1962 për shkak të aleancës së saj me Bashkimin Sovjetik dhe përfshirjes në krizën e raketave Kubane. Për më tepër, shumë vende të Amerikës Latine u zhgënjyen kur Shtetet e Bashkuara mbështetën Britaninë në luftën e saj me Argjentinën mbi Ishujt Falkland. Kjo, dhe shqetësimet për përfshirjen e SHBA-së në luftërat në Lindjen e Mesme, bëri që Meksika të tërhiqej nga traktati në vitin 2002. Gjatë 15 viteve të ardhshme, Bolivia, Ekuadori dhe Nikaragua u larguan gjithashtu për të krijuar një aleancë të re të tyre.

Traktati ANZUS

Emri i plotë i traktatit ANZUS është Traktati i Sigurisë së Australisë, Zelandës së Re dhe Shteteve të Bashkuara. Ky pakt i sigurisë kolektive filloi në vitin 1951 për të zyrtarizuar bashkëpunimin midis këtyre vendeve anglisht-folëse për të ruajtur sigurinë në Paqësorin Jugor. Australia dhe Zelandë e Re ishin të shqetësuar për përhapjen e komunizmit në Azinë Juglindore dhe mendonin se Mbretëria e Bashkuar ishte shumë e preokupuar me çështjet evropiane për të ofruar ndihmën e duhur, kështu që ata i shikonin Shtetet e Bashkuara si një partner. Australia dhe Zelandë e Re dërguan forca për të mbështetur Shtetet e Bashkuara në Luftën e Vietnamit.

Zgjerimi dhe kontraktimi i ANZUS

Edhe pse asnjë vend i ri nuk i bashkua ANZUS-it përveç tre vendeve origjinale, nga viti 1954 deri në 1977 ata të gjithë iu bashkuan një organizate të re traktati: SEATO (Organizata e Traktatit të Azisë Juglindore, e njohur gjithashtu si Pakti i Manilës). Kjo përfshinte Australinë, Francën, Zelandën e Re, Pakistanin, Filipinet, Tajlandën, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Pakistani u largua nga SEATO kur aleanca nuk arriti ta mbështeste atë në luftën e saj me Indinë. Kur Lufta e Vietnamit përfundoi në 1975, organizata humbi qëllimin e saj kryesor dhe u shpërbë disa vjet më vonë. ANZUS nuk është shpërbërë, por në vitin 1984 Zelandë e Re e shpalli veten një zonë jo-bërthamore dhe refuzoi të lejonte nëndetëset amerikane me energji bërthamore të vizitonin portet e saj. Dy vjet më vonë, Shtetet e Bashkuara njoftuan se po pezullonin detyrimet e traktatit ndaj Zelandës së Re.

Traktatet dypalëshe të mbrojtjes

Shtetet e Bashkuara kanë nënshkruar traktate të mbrojtjes reciproke me disa vende që nuk janë pjesë e një aleance më të gjerë sigurie. Këto përfshijnë Filipinet (1951), Korenë (1953) dhe Japoninë (1960). Të tre janë në buzë të Paqësorit të Azisë, dhe të tre janë vende ku veteranët amerikanë kanë luftuar në të kaluarën për liri, duke përfshirë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe

Luftës së Koresë. Aleancat me këto vende ruajnë lirinë e deteve dhe përmbajnë ndikimin dhe ekspansionizmin e kundërshtarëve rajonalë: Rusisë, Koresë së Veriut dhe Kinës.

Aleatët kryesorë jo-NATO

Në epokën moderne, nuk është gjithmonë e dobishme të hysh në një aleancë formale me një vend tjetër, veçanërisht nëse Shtetet e Bashkuara duan të mbajnë marrëdhënie të mira si me atë vend ashtu edhe me rivalët e tij lokalë. Megjithatë, në vitin 1987, Kongresi miratoi legjislacionin që lejonte SHBA-në të hynte në marrëdhënie bashkëpunimi me miq të rëndësishëm të Shteteve të Bashkuara jo-NATO.

Statusi i “Aleatit të Madh Jo-NATO” u lejon këtyre vendeve të marrin trajnime ushtarake të SHBA-së, të blejnë raunde anti-tanke të uranimit të varfëruar, të marrin pajisje dhe furnizime të tepërta ushtarake amerikane, të strehojnë rezervat e rezervave amerikane të luftës të pajisjeve në pronësi të SHBA-së, të marrin pjesë në kërkime bashkëpunuese dhe zhvillimi, fitimi i aksesit në teknologjinë hapësinore, marrja e financimit amerikan për blerjen ose dhënien me qira të pajisjeve mbrojtëse dhe përfitime të tjera.

Aleatët aktualë të mëdhenj, jo anëtarë të NATO-s

Vendet aktuale me statusin MNNA janë Argjentina, Australia, Bahreini, Brazili, Kolumbia, Egjipti, Izraeli, Japonia, Jordania, Kuvajti, Katari, Maroku, Zelandë e Re, Pakistani, Filipinet, Singapori, Koreja e Jugut, Tajlanda dhe Tunizia. Tajvani nuk ka status zyrtar MNNA për të shmangur provokimin e Kinës, por Kongresi ka mandatuar që atij t'i jepen të njëjtat privilegje.

Statusi i MNNA nuk do të thotë se Shtetet e Bashkuara janë të detyruara nga traktati t'i mbrojnë këto vende. Megjithatë, SHBA-ja ka traktate dypalëshe të mbrojtjes me disa prej tyre siç përshkruhet më herët në këtë artikull. Vendi më i diskutueshëm në këtë kategori është Pakistani. Disa herë janë bërë mocione në Kongres për të hequr statusin e saj MNNA për shkak të pjesëmarrjes së tij të dobët në përpjekjet kundër terrorizmit.

Aleatët e ardhshëm të mundshëm të mëdhenj jo-NATO

Vendet në Evropën Lindore dhe Gjirin Persik janë sugjeruar si aleatë të mëdhenj potencialë jo-NATO që kanë nevojë për mbrojtje nga Rusia dhe Irani, respektivisht. Këto përfshijnë Armeninë, Gjeorgjinë, Moldavinë, Ukrainën, Arabinë Saudite, Irakun, Omanin dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Për shkak se statusi MNNA nuk kërkon që Shtetet e Bashkuara të vijnë në mbrojtje të këtyre vendeve, do të ishte e mundur edhe në raste si Ukraina, ku po zhvillohet një luftë aktive me Rusinë.

India është përcaktuar si një “Partner i madh i mbrojtjes” me shumë nga të njëjtat privilegje si një MNNA, por vetëm pak nga ai status i plotë. India është kombi më i populluar në botë, demokracia më e madhe në botë dhe një fuqi e madhe ekonomike dhe ushtarake në rritje. Është një partner i rëndësishëm me Shtetet e Bashkuara për të balancuar ambicionet e Kinës fqinje. Megjithatë, rivaliteti i saj i ashpër me Pakistanin do të thotë se SHBA-ja ka shumë të ngjarë të favorizojë njërin ose tjetrën. Në vitet e fundit, bashkëpunimi i papërsosur i Pakistanit në Luftën kundër Terrorit ka qenë megjithatë i dobishëm ndonjëherë në teatrin e Afganistanit.



Shkencëtarët kinezë kanë gjetur një mënyrë për t'i bërë raketat hipersonike më të fuqishme

Një ekip shkencëtarësh në Kinë besojnë se kanë gjetur një mënyrë për t'i bërë raketat hipersonike më të fuqishme, duke zgjeruar rrezen e tyre duke "kapërcyer" në atmosferë. Studiuesit nga Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit të Aerodinamikës së Kinës thonë se metoda do të përfshinte një automjet me rrëshqitje hipersonike që ngrihet vazhdimisht lart dhe më pas bie në skajin e atmosferës së Tokës ndërsa udhëton drejt objektivit të tij.

Teknika quhet skip-gliding, ku automjeti fluturon në skajin e hapësirës dhe më pas kërcen nga shtresat e sipërme më të dendura të atmosferës së Tokës si një gur që kërcen mbi ujë.

Kjo potencialisht do të rriste rrezen e një rakete hipersonike deri në 34% dhe kohën e fluturimit të saj me 28%, sipas simulimeve të tyre, të cilat u botuan në revistën e "Journal of Astronautics".

"South China Morning Post" me bazë në Hong Kong raportoi mbi hulumtimin e tyre, duke shkruar se mund të lajmërojë përdorimin e raketave hipersonike që kalojnë nga "konflikti rajonal në operacionin global".

Shkencëtarët kinezë, të udhëhequr nga autori kryesor Yong Enmi, thanë se puna e tyre ishte frymëzuar pjesërisht nga avioni hapësinor "Silbervogel" i parashikuar nga inxhinierët e hapësirës ajrore nën Gjermaninë naziste dhe projekti "Dyna-Soar" i Forcave Ajrore të SHBA-së në vitet 1950.

Të dy avionët ishin projektuar për të mbuluar distanca të mëdha me shpejtësi të lartë, duke përdorur rrëshqitje, por asnjëri nuk u ndërtua ndonjëherë.

Ekipi i Yong tha se simulimet e tyre kompjuterike treguan se raketat hipersonike të Kinës mund të udhëtojnë me shpejtësi deri në 20 Mach dhe, pas një ore fluturimi, të ruajnë ende një shpejtësi prej 7 Mach ndërsa kalojnë në atmosferë.

Shumica e raketave hipersonike mendohet se ndjekin një trajektore fluturimi shumë të ndryshme. Zakonisht ato lëshohen lart në qiell, ndonjëherë në hapësirën e ulët dhe rrëshqasin drejt objektivit të tyre përpara se të rihynë në atmosferë për të goditur.

Kur Kina testoi një version që mund të qarkullonte rreth globit në vitin 2021, SHBA-të mbetën të shtangur. Uashingtoni dukej se ishte kapur i befasuar nga sa shpejt Pekini e kishte zhvilluar teknologjinë dhe ishte i shqetësuar se kjo do të shkaktoje telashe për sistemet e mbrojtjes rakitore.

Një arsenal i plotë hipersonik kinez me një gamë të gjerë do të kishte implikime serioze ushtarake, tha për "Business Insider" Jennifer Kavanagh, drejtore e Analizës Ushtarake në grupin e ekspertëve me bazë në Uashington, Defence Priorities.

Kjo do të thotë që Ushtria Çlirimtare Popullore mund t'i lëshojë këto armë nga larg brenda Kinës dhe ende të godasë thellë në territorin amerikan, potencialisht në Oqeanin Paqësor apo edhe në Hawai ose në territorin e SHBA-së, tha Kavanagh.

"Do të jetë më e lehtë për PLA të mbrojë dhe më e vështirë për Shtetet e Bashkuara të gjejë dhe të synojë sistemet e raketave të bazuara thellë brenda Kinës sesa ato që duhet të pozicionohen përgjatë bregdetit", - tha ajo.

Raketat rrëshqitëse mund të jenë gjithashtu më të vështira për t'u gjurmuar dhe përgjuar, shtoi ajo.

Por ky hulumtim përfshinte vetëm simulime dhe jo teste aktuale të raketave, tha Kavanagh. Edhe nëse Kina do të ishte në gjendje ta përthente këtë në një armë praktike, ka të ngjarë të ishte e shtrenjtë dhe e ndërlikuar për t'u prodhuar.



“SHKENCËTARËT KINEZË, TË UDHËHEQUR NGA AUTORI KRYESOR YONG ENMI, THANË SE PUNA E TYRE ISHTE FRYMËZUAR PJESËRISHT NGA AVIONI HAPËSINOR “SILBERVOGEL” I PARASHIKUAR NGA INXHINIERËT E HAPËSIRËS AJRORE NËN GJERMANINË NAZISTE DHE PROJEKTI “DYNA-SOAR” I FORCAVE AJRORE TË SHBA-SË NË VITET 1950.

"Teoria dhe praktika mund të jenë shumë të ndryshme kur bëhet fjalë për rrezet e raketave", - tha Kavanagh.

Raketat hipersonike janë veçanërisht të vështira për t'u manovruar pasi ato bëhen më të shpejta dhe kanë tendencë të nxehen shpejt me shpejtësi maksimale.

Kavanagh vuri në dukje se një raketë e ardhshme rrëshqitëse ka të ngjarë të jetë ende e zbulueshme nga qindra milje larg.

David Kearn, një profesor i asociuar i Qeverisë dhe Politikës në Universitetin St. John's, vuri në dukje disa shqetësime në administratën e Bidenit në lidhje me instalimin e raketave hipersonike nga Kina me koka bërthamore.

"Disa ekspertë kanë spekuluar se HGV-të kanë potencialin për një aftësi 'bombardimi orbital të pjesshëm' që mund të krijojë një kërcënim për prerjen e kokës për udhëheqjen amerikane", - tha Kearn, i cili hulumton raketat dhe armët bërthamore.

Kearn beson se çështja është duke u tejkaluar pasi Kina ka aftësinë për të nisur sulme bërthamore pavarësisht nga raketat e saj hipersonike.

Sa i përket ndikimit të kalimit të rrëshqitjes në atë se sa mirë mund të qëndrojnë raketat kineze kundër mbrojtjes së SHBA-ve nga pikëpamja e aftësive, Kearn nuk sheh shumë ndryshim.

"Meqenëse sistemet ekzistuese të automjeteve me rrëshqitje hipersonike tashmë ofrojnë aftësinë për të mposhtur mbrojtjen e raketave balistike amerikane, nuk është e qartë se çfarë do të shtonte trajektorja e 'gurit të kapërcyer'", - shtoi ai.

Ekipi i Yong tha se hulumtimi i tyre tregoi se kapërcimi ofron më shumë avantazhe për raketat hipersonike, por pranoi se ata kishin parë vetëm kohën e fluturimit, shpejtësinë dhe stresin në raketë. Hapi i tyre i ardhshëm, thanë ata, do të ishte të hulumtojnë se sa lehtë mund të manovrojnë dhe të lundrojnë anash një raketë rrëshqitëse.

Shqipëria, atraksioni magjepsës i bukurive natyrore

“Shpella e Orëve” në Gojan të Pukës

Qyteti verior i Pukës konsiderohet si një aventurë e bukur turistike e çdo stine, ndërsa është kthyer në qendër atraksioni turistik për vizitorët vendas e të huaj. Për vizitorët e natyrës, zonat më të vizituara në territorin e bashkisë Pukë mbeten shpellat, ku deri tani janë të evidentuara mbi 50 të tilla. Një pjesë e tyre gjenden pranë zonave të banuara, të cilat që prej lashtësisë janë përdorur si vendstrehime apo vende të sigurta. “Shpella e Orëve” në Gojan të Pukës, unike në llojin e saj në Shqipëri, kryeministri u shpreh se: “Deri në vitet 1960 ajo ka shërbyer edhe si vend pelegrinazhi”. “Shpella e Orëve” është një shpellë e vogël, por mjaft e bukur dhe e veçantë, e vetmja në llojin e saj në Shqipëri. Burimi i ujit që rrjedh sipër saj e mbulon shpellën nga të gjitha anët deri poshtë në përrua, duke krijuar formacione të jashtëzakonshme dhe një pamje tepër panoramike të gjithë zonës përreth. Deri në vitet ’60, kjo shpellë, ka shërbyer edhe si vend pelegrinazhi dhe këtë e tregon edhe emri i saj “Shpella e Orëve”, pra vendi ku rrinë “Orët” (krijesa mitologjike). Shpella është e njohur nga banorët e kësaj zone si vend i shenjtë, por edhe me veti shëruese.



“Shpella e Orëve” është një destinacion i cili gjendet 21 km larg qytetit të Pukës, në fshatin Gojan. Ajo tërheq vëmendjen me të veçantat e saj: historinë intriguese, forma unike, sfondin panoramik dhe burimin e ujërave minerale që i jep një hije si një “Kërpudhe e Artë”.



Shpella e Valit

Shpella e Valit ndodhet në lindje të fshatit Perlat në Komunën Kthellë, të krahinës së Mirditës. Si njësi natyrore ajo është pjesë e sistemit të bjeshkëve të Selitës, Mulli – Didhe – Valmor, me lartësi 1300 – 1500 mbi nivelin e detit, sistem të cilin e çan mes përmes lugina e Urakës, duke krijuar një pejzash e bukuri të admirueshme mjaft tërheqëse. Në pjesën Perëndimore të luginës së Urakës, ndodhet vargu kodrinor që zë fill me bjeshkën e Mullit në Veri që nuk i kalon 1300 metra, vijon me Qaf-kishën rreth 1000 m, me Pllejën (pllajën) e Bozhikut 600 – 700 m, maja e Ngallit në Lufaj me 500 – 600 m dhe mbyllet në jug gjithë vargu kodrinor me Shkëmbin e Valit, rreth 500 m lartësi mbi nivelin e detit, nga ku kalohet në Qafen e Valit që lidh zonën e Perlatit me atë të Laç- Bruçit të rrethit të Matit. Në jug të këtij vargu kodrinor ndodhet shpella e Valit, që është dhe pjesa fundore e tërë këtij sistemi, mbi shpinën e së cilës shtrihet pllaja me të njëjtin emër. Formacioni tokësor i kësaj shpelle zotërohet nga shkëmbinj gëlqeror që i përkasin erës Mesazoike me përpunim të dukshëm në periudhën e Kreasit me trashësi 3000 – 4000 m, poshtë të cilave ndodhen dhe të tjerë terrigjene, që krahasimisht mund të datohen me



5 – 6 milion vjet më parë e më tej. Morfologjia e formacioneve të kësaj shpelle në rrjedhën e historisë së formimit gjeologjik të saj, i është nënshtruar një sërë sinklinalësh, e antiklinalësh (Lëvizje të brendshme) me kalimin e kohës, duke shfaqur mbi sipërfaqen e tokës të sistemit kodrinor një linjë të copëtuar në formën e valëve të njëpasnjëshme, fundi i të cilave mbyllet me këtë shpellë. Këtej mendohet dhe emërtesa e kësaj shpelle me emrin: Vala – Vale – Vali, mbasi ndër kohëra e brezni gjeneratash, “etimologët” popullorë e kanë quajtur e thirrur dhe sot e kësaj dite SHPELLA E VALIT. Në territorin përkatës, ajo ndodhet në lindje të fshatit Perlat. Në Veri e Verilindje kufizohet me fshatin Lufaj të komunës Selite, në Jug e Juglindje kufizohet me fshatrat Bruç e Kodër-Laç të rrethit të Matit.

m, çka tregon dhe trashësinë e mbulesës shkëmbore të shpellës, pa përjashtuar dhe shtresën e dherave që janë të pranishme mbi të. Shkëmbinjtë janë organike e me soliditet të qartë, të përbëra nga gëlqerorë, ndoshta unikë në tërë sistemin kodrinor që trajtuam dhe mjaft të pasur me karbonate eprorë, të njohur gjithashtu si shkëmbinj calcite, të lakuara lehtësisht nga veprimi eroziv i ujërave rrjedhëse, duke ndërhur në paqëndrueshmërinë e njëtrajtshme të formës e masës së tyre. Fenomeni i Karstit, dukuri e cila vërehet gjerësisht në tërë masën shkëmbore, dëshmi të cilat janë një numër i madh pothuaj i pafund i stalaktiteve që kanë forma e përmasa të ndryshme jo vetëm në trajtë, por dhe në formë, duke krijuar një ansambël natyror apo një dekor artistik që të josh e ndjell në brendësinë e saj të mistershme. Peizazhi relievor me elementet e tij përbërës ka ndikuar ndjeshëm në fuqinë gërryese të ujërave rrjedhëse sidomos në stinën e pranverës e të dimrit dhe të favorizuara nga pjerrësia e terrenit përfshirës, kanë krijuar jo vetëm gërryerje e çarje të thella të shkëmbinjve, por vende-vende dhe shpëlarje e çarje të formacionit, proces i cili është evident e në progres dhe në ditët e sotme. Këtë proces në rritje e stimulon dhe mungesa e një mbulese të dendur bimore sidomos atyre të druve pyjor, që janë dëmtuar pothuaj tërësisht nga shfrytëzimi pa kriter që i është bërë në këto 60 – 70 vitet e fundit. Shpella e Valit, si objekt natyror, pothuaj nuk është evidentuar e as bërë ndonjë studim enkas për të. Me gjithë kureshtjen që ajo ka ngjallur në vijimësi. Po ashtu mund të thuhet se mungon deri më tani dhe interesi për vlerat social-ekonomike e kulturore që ajo ka e që mund të shfrytëzohet në dobi të komunitetit. Fakti që masivet e gurit gëlqeror në përmasa të pallogaritshme dhe të një cilësie të lartë, përbëjnë një pasuri shumë të madhe për industrinë e ndërtimit. Vlerat kulturore në nivelin e një monumenti të këtij lloji dhe peizazhi mahnitës përbëjnë vlera për industrinë e turizmit. Që të shfrytëzohet kjo pasuri, deri më tani e fjetur dhe e pa vlerësuar, kërkon domosdo ndërhurje gjithëplanëshe të pushtetit vendor të komunitetit dhe institucioneve përkatëse të linjës.

Gjëja e parë që duhet bërë është ndërhurja në infrastrukturën e këtij objekti siç është lidhja e tij me rrugën automobilistike të zonës që nuk i kalon 3 – 4 km. Furnizimi i shpellës me ujë të pijshëm është lehtësisht i mundur, duke shfrytëzuar burimin që është në afërsi të saj. Po kështu dhe marrja e energjisë elektrike, është plotësisht e mundur mbasi aty pranë ka disa shtëpi banimi të cilat janë të lidhura me rrjetin elektrik të zonës. Vetë shpella për ndonjë kompozim të mundshëm kërkon një mundësi investim modest. Edhe në këto kushte që është, ajo është mjaft e vizitueshme. Dhjetëra e qindra nxënës e mësues, jo vetëm të zonës, por dhe nga shkollat e krahinës si: Rrëshenit, Rubikut, të Selitës, e të rretheve të tjera si të: Lurës, Bruçit, Urakës, dhe vizitorë të kategorive të tjera. Do të mjaftonte ndërgjegjësimi i të gjithë palëve për të rritur shkallën e preokupimit për vlerësimin dhe shfrytëzimin e vlerave të këtij objekti natyror me rendësi në fushën e kulturës dhe të ekonomisë.

Qafa në jug të shpellës bën të mundur lehtësisht kalimin këmbësor të banorëve të komunave fqinje midis Kthellës dhe Bruçit. Shpella e Valit ngrihet në brinjë të fushës me te njëjtin emër dhe ka pamjen e një kështjelle natyrore me blloqe vigane gëlqerorësh përafërsisht me këto përmasa. Fillimi i hyrjes nga Perëndimi në Lindje 90 – 100 m e gjatë që përfundon pothuajse me dy dalje, njëra prej të cilave mendohet se ka një lidhje labirint me shpellën e NEZIRIT të Bruçit, e cila ka vlera arkeologjike me përmbajtje të historisë së lashtësisë Iliro – Shqiptare.

Gjerësia nga Veriu në Jug në hapësirën e hyrjes varion në 50 – 60 m. Shpella në qendër të saj ka një oxhak hinkë nga sipërfaqja në shpinë të saj, pingul me thellësinë që lidh ambientin e brendshëm të shpellës me atë të jashtëm Diametri i oxhakut është 10 – 15 m dhe thellësia e tij pingul nga lart e deri në sipërfaqen e tavanit është përafërsisht 20 – 25



Atdheu përjetë mirënjohës!

Në panteonin e artë të historisë së kombit kulmon një nga ngjarjet më të mëdha, epopeja e ngadhënjishme e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Kjo luftë në rrugëtimin e kombit shkroi lavdinë e tij. Sado që kohët ecën dhe largojnë madhështinë hyjnuuese të kësaj epopeje, gjaku i derdhur i bijave dhe bijve të kombit thërret në histori, thërret për atë çka ata dhanë jetën në lulen e rinisë.

Liria për të ishte gjëja më e shenjtë, ishte mbi jetën. Me patosin e shpirtit, rrokën armët qindra e mijëra vetë e iu ngjitën maleve në luftë, ku shkruan një histori dritëdhënëse, përballë një armiku të egër, të madh, çnjerëzor, që kërkonte të rrëronte e zhdukte lirinë e kombit, ekzistencën e tij. Por një popull i tërë, i etur për liri, që kishte treguar se atdheu ishte më i shtrenjtë se çdo gjë, shkroi histori të pa treguar, që sot ngelen si gurë themeli të kujtesës së tij historike. Pëllëmbë e tokë, gjak e histori, partizanët, bijtë e tij, kumtuan mesazhin e madh se gjaku i derdhur do të ishte flamuri i kombit, lartësimi i tij në çdo moment të jetës, flamuri dhe ylli ishin që i udhëhoqi në përpjekje, në beteja, në gjakderdhje, kur dhe shokët i binin pranë, ata ngritën lart atë flamur që simbolizon sot qytetërimin tonë.

Mustafa Matohiti / Hero i Popullit

Mustafa Matohiti u lind në Lekdush, më 15 nëntor 1912. Mbaroi shkollën fillore dhe atë plotore në Delvinë. I ati Sabriu rropatej në punë të ndryshme për bukën e gojës, por të birin donte ta shkollonte. Varfëria dhe shtypja ziente përbrenda çdo zemre. Mustafai ishte 17 vjeçar, kur më 28 nëntor 1929, në Gusmar, qendër e n/prefekturës së Kurveleshit, mori iniciativë dhe tha: “Neve kurveleshasve na urrejnë armiqtë e kjo na gëzon dhe do t’i luftojmë akoma më shumë”. Kjo protestë tregon jo vetëm urrejtjen kundër padrejtësive, por edhe zgjuarsinë dhe guximin e Mustafait.

Në vitin 1929 Mustafai u punësua në Tiranë, tek një farmacist. Donte të vazhdonte shkollën, por askush nuk e ndihmonte. Me durim dhe vullnet fitoi në një konkurs provimesh dhe u fut në një shkollë oficerësh. Në shkollë u lidh ngushtë me Asim Vokshin, Hero i Popullit. Në verën e vitit 1933 mbaroi shkollën dhe doli oficer për artilerinë. Emërohet në Elbasan, ku njihet me shumë elementë antizogistë, të cilëve u fliste për historinë dhe luftërat e popullit tonë për liri dhe pavarësi. Në maj 1937 e arrestuan xhandarët e Zogut për veprimtarinë atdhetare dhe e burgosën në Tiranë. Regjimi zogist e përjashtoi nga radhët e ushtrisë dhe i dha banim të detyrueshëm në Delvinë. Madje qeveria zogiste ia kishte shënuar emrin në defterin e njerëzve më të rrezikshëm të regjimit. Pas kësaj, Mustafanë e dërguan me banim të detyrueshëm në Lekdush nën një mbikëqyrje të rreptë. Në nëntor 1938 ai arratiset dhe shkoi në Greqi me shpresë që të shkonte në Luftën e Spanjës, ku ndodheshin Asim Vokshi, Petro Marko, Ramiz Varvarica e të tjerë, por autoritetet greke e ndaluan dhe e dorëzuan te xhandarmëria shqiptare, ku për dy muaj ai iu nënshtua torturave.

Agresionin fashist, të 7 Prillit 1939, e priti me një zemërim prej atdhetari të vërtetë. Në 1941 u ndodh në Pigeras, ku zhvilloi veprimtarinë patriotike në bashkëpunim me Mitro Khanin. Më 18 mars 1942, në kujtim të Luftës së Mashkullorës nga çeta e Çerçiz Topullit, Mustafa Matohiti para autoriteteve dhe popullit mbajti një fjalim të zjarrtë patriotik. Në fund ai nga gjiri nxori një flamur kombëtar, mbi të cilin qe shkruar: “Sot me flamur shpalosur, nesër me pushkë në dorë maleve!”. Kështu deklaroi Mustafai në Mashkullorë dhe ai s’la katund e kasolle pa ligjëruar si bilbili për idealet e luftës për liri. Me udhëzim të Qarkorit të PKSH-së për Gjirokastrën, në lajthitë e Gusmarit, në prill 1942, formoi çetën partizane, ku komisar të saj luftëtarët e lirisë caktuan Mustafa Matohitin... Me iniciativën, pjekurinë e maturinë, Mustafai brenda muajve mars-maj 1942, krijoi në zonën e Kurveleshit këshillat antifashiste nacionalçlirimtare dhe njësitë e armatosura pranë tyre... Në maj 1942, në Kuç u formua celula e parë komuniste për Kurveleshin dhe sekretar u caktua Mustafa Matohiti, i cili ishte njëkohësisht dhe komisar i çetës së parë partizane të krahinës.

Më 28 nëntor 1942, në ditën e 30-vjetorit të Pavarësisë Kombëtare, në krye të 250 kryengritësve kurveleshas, sulmon administratën fashisto-zogiste dhe me trimëri, guxim e mençuri korri një fitore historike që pati një mbështetje të madhe mbarë popullore në Kurvelesh e më larg. Kurveleshi u çlirua nga vargonjtë e mercenarëve dhe pushtuesve fashistë.

Mustafa Matohiti ishte njeri i aksionit të guximshëm, por ai shquhej edhe për oratorinë e përsosur. Fjala shpatë e barut e Mustafait që bashkë me Mehmet Shehun dhe Abaz Shehun demaskuan me argumente krerët ballistë Ali bej Këlcyra, Rasim Babameto, Zenel Gjoleka, atje në rrapet e Dervenit, më 4 maj



1943. E ku nuk shkeli këmba e Mustafait!? E njohu Kurveleshi, Lopësi e Mesapliku, Buzi, Rrëzoma e Krahësi, Bënça, Bregdeti e Përmeti, Kardhiqi, Gjirokastra e Mallakastra, Zagoria, Dëshnica e Poliçani, Tepelena e Konispoli... Aftësitë drejtuese, organizuese dhe fryma luftarake e tij u shfaqën edhe kur u emërua komisar i Grupit të Katërt “Çamëria”, apo kur u caktua komisar i Brigadës

VI Sulmuese, më 26 janar 1944. Brigada VI Sulmuese zhvilloi shumë beteja dhe në njërën prej tyre, në atë të 29 marsit 1944, në Mërgëlliç, Mustafa Matohiti, Dino Kalenja, Lefter Talo dhe Meleq Gosnishti, të katër Heronj të Popullit, me gjakun e tyre të kulluar do të shkruanin pavdekësinë dhe lirinë që do të vinte më 29 nëntor 1944, përmes pushkës fitimtare partizane.



Meleq Gosnishti / Hero i Popullit. U vra gjatë luftimeve për marrjen e kalasë së Margëlliçit në Patos, më 30 mars 1944. Lindi në fshatin Gosnisht të Përmetit. I biri i Iliaz dhe Hatixhe Gosnishtit. Qe fëmija më i madh nga shtatë fëmijët e kësaj familje. Emigroi që në moshën 14 vjeçare drejt Parisit dhe u kthye më vonë për të marrë pjesë në Luftën për çlirimin e Vëndit. U vra teksa po luftonte në Kalanë e Margëlliçit së bashku me të tjerë partizanë dhe me shokun e tij, Heroin e Popullit, Mustafa Matohitin. Dy ditë pas vrasjes së tij, në Tiranë gjeti vdekjen dhe vëllai i tij i vogël Zini Gosnishti. Varri i tij gjendet ende në rrethin e Përmetit. Për nder të këtij heroi ka marrë emrin e tij një ndër shkollat më të mira 9-vjeçare të rrethit të Përmetit, gjimnazi i Patosit dhe një rrugë në Tiranë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



Vijojnë regjistrimet e kandidatëve për:

- Ushtar / Detar aktiv (afati i dorëzimit të dokumentacionit deri, më 26 Gusht 2024);
- Kursi për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura
(afati i dorëzimit të dokumentacionit deri më 23 Gusht 2024)

Për më shumë informacion na kontaktoni në numrin e telefonit:

+ 355683404896